



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në:

**Inxhinieri Ndërtimi me profile: “Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit”;
“Menaxhim i Ndërtimeve”; “Inxhinieri e Resurseve Ujore”; “Inxhinieri e
Materialeve të Ndërtimit”**

Univesiteti “EPOKA”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Assoc. Gafur Muka;

Dr. Egla Luca;

Shkurt / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master i Shkencave në: Inxhinieri Ndërtimi me profile: “Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit”; “Menaxhim i Ndërtimeve”; “Inxhinieri e Resurseve Ujore”; “Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit”

1	IAL aplikues:	Universiteti "EPOKA"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në: Inxhinieri Ndërtimi me profile: “Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit”; “Menaxhim i Ndërtimeve”; “Inxhinieri e Resurseve Ujore”; “Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 90, datë 10.02.2010; Shkresë e MASR Nr. 586/1 prot., datë 27.03.2018;
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr. 565, datë 22.11.2011 *
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 07, datë 01.02.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/ 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)

17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit, për vitin akademik 2022-2023	5 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	<p><u>Profili Inxhnieri e Strukturave:</u> 2021-2022 8 studentë 2022-2023 18 studentë</p> <p><u>Profili Inxhnieri e Resurseve Ujore:</u> 2021-2022 1 student 2022-2023 0 student</p> <p><u>Profili Inxhnieri e Materialeve të Ndërtimit:</u> 2021-2022 0 student 2022-2023 0 student</p> <p><u>Profili Menaxhim i Ndërtimeve:</u> 2021-2022 2 studentë 2022-2023 2 studentë</p>
19	Komente / të tjera:	-

**Ky urdhër është vetëm për dy profile "Inxhinieri e strukturave" dhe "Menaxhim i Ndërtimeve"*

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "Epoka", është një institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 281, datë 12.03.2008. Universiteti "Epoka", zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Universiteti "EPOKA" ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.92, date 20.10.2017, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 19.10.2021, dhe riakredituar me VBA Nr. 54, datë 16.12.2021, me kohëzgjatje 6 vite akademike me afat vlefshmërie deri në 15.12.2027. Universiteti "Epoka", është i organizuar në 3 fakultete, konkretisht:

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë;
2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative;
3. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale;

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile: Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit; Menaxhim i Ndërtimeve; Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit; dhe Inxhinieri e Resurseve Ujore, i Universitetit "EPOKA" ofrohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, përkatësisht Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit. Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në gjuhën angleze.

Programi i Studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi" të ciklit të dytë, në formë të studimeve me kohë të plotë me profilet: Inxhinieri e strukturave të Ndërtimit; Menaxhimi i Ndërtimit, është licencuar me VKM Nr. 90, datë 10.02.2010 "Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së Lartë private "EPOKA". Me Urdhër të MASH Nr 379, datë 19.07.2010 "Lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë për hapjen e programeve të reja të studimit, shkollës së lartë private "Epoka", është lejuar veprimtaria akademike në vitin akademik 2010-2011. Ky program është akredituar për herë të parë me Urdhër i MASH Nr. 286, datë 06.07.2012, bazuar në VKA Nr. 339, datë 08.06.2012 (Akreditohen, me rekomandime dy profilet)

Universiteti "Epoka" ka paraqitur kërkesën për miratimin e riorganizimit të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, duke shtuar dy profile të reja: c) Inxhinieri e Resurseve Ujore dhe d) Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit. Ndryshimet profilizuese në fjalë janë miratuar me vendimin nr. 3 datë 10.12.2014 të Senatit Akademik dhe aprovuar me shkresën e MASR Nr. 586/1 prot., datë 27.03.2018. Nga Takimet me drejtuesit e Njësisë, u deklarua se këto dy profile u hapën për herë të parë në vitin akademik 2018-2019. Programi me të katërt profilet është akredituar me VBA nr 07, datë 01.02.2019.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile: Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit; Menaxhim i Ndërtimeve; Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit; dhe Inxhinieri e Resurseve Ujore i Universitetit "EPOKA" ofrohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, përkatësisht Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, filloi me prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të vlerësimit të brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017", ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti "Epoka", për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. As. Gafur Muka dhe PhD. Egla Luca. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirmeli. Vizita në Universitetin "EPOKA", u realizua në datën 11-12/10/2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas axhendës së vizitës në IAL. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit bazuar në Vendimin Nr.7 datë 01.02.2019 janë:

1. Institucioni të rishikojë shpërndarjen e lëndëve dhe krediteve sipas llojit të veprimtarisë, uljen e përqindjes së lëndëve me zgjedhje dhe rritjen e përqindjes së lëndëve të detyrueshme;
2. Institucioni të parashikojë në kurrikulën e këtij programi studimi praktikën profesionale/intershipin si një modul të vecantë;
3. Rekomandohet që Institucioni të rishikojë planin mësimor duke diversifikuar lëndët me emërtim të njëjtë midis programit Master i Shkencave dhe atij profesional dhe për pasojë

procesin e transferimit të studentëve nga ai profesional në atë shkencor, përfshirë kriterin e mesatares në hyrje;

4. Institucioni të zbatojë orët në auditor të planifikuara në planin mësimor dhe të përditësojë syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi duke, përfshirë në to literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Sipas dokumentave të vëna në dispozicion, dhe vizitës në institucion, u konstatua se është përditësuar shpërndarja e lëndëve dhe krediteve sipas llojit të aktiviteteve. **GVJ konkludon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**
2. Nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe nga vizita në IAL, rezulton që rekomandimi është plotësuar në përputhje me qëllimin e përshkruar në rekomandim. Praktika profesionale tani më është lëndë e detyrueshme. **GVJ konkludon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**
3. Nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe nga vizita në IAL, rezulton që rekomandimi është plotësuar në përputhje me qëllimin e përshkruar në rekomandim. **GVJ konkludon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**
4. Nga shqyrtimi i dosjes së vetëvlerësimit dhe nga vizita në IAL dhe takimi me studentët, rezulton që rekomandimi është plotësuar në përputhje me qëllimin e përshkruar në rekomandim. Orët javore të klasës janë përditësuar në kurrikulën e re, duke përfshirë orët laboratorike dhe praktike. Gjithashtu sylabuset janë plotësuar me literaturë të detyrueshme dhe të rekomanduar. **GVJ konkludon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

Universiteti "EPOKA" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 11.01.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 44 / Prot, datë 11.01.2024. Universiteti "EPOKA" më datë 24.01.2024, përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës Nr. 131/9 Prot, datë 17.01.2024, "Përcillet informacion në lidhje me Draft Raportin për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile: Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit; Menaxhim i Ndërtimeve; Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit; dhe Inxhinieri e Resurseve Ujore

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti Epoka, Fakultetit i Arkitekturës dhe Inxhinierisë si dhe Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, synojnë të ngrejnë kufijtë e njohurive nëpërmjet përsosjes së arsimit, rritjes intelektuale, shkencore, sociale dhe kulturore të studentëve. Ky kontribut në përmirësimin e komunitetit është i rrënjësor në aspiratën e një mjedisi intelektual që kultivon të menduarit kritik dhe krijues, duke mbështetur vlerat institucionale akademike, parimet dhe etikën. Programi i studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi me Profile është një komponent instrumental në ndjekjen e këtij objekti.</p> <p>Misioni i Universitetit EPOKA: <i>të jetë një institucion mësimor-kërkimor inovativ dhe me ndikim, në shërbim të vlerave njerëzore thelbësore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe zdurrvillimit të dijeve në nivel ndërkombëtar, si dhe të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë mbështetur në nevojat kombëtare dhe rajonale. Në këtë kuadër, Universiteti "Epoka" synon të rrisë individë të mirëkualifikuar, produktivë dhe të aftë, me shpirt të orientuar drejt kërkimit, etikë profesionale dhe ndjeshmëri shoqërore, si dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare</i></p> <p>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni mbështetës (<i>Rregullorja e programit</i>) dhe (<i>Statuti i Universitetit Epoka</i>), u konstatua se Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit", të Universitetit "EPOKA", është hartuar në përputhje me Statusin e</p>

	<p>Universitetit EPOKA, neni 3, misionin dhe qëllimet e institucionit.</p> <p>Bazuar në Misionin dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit EPOKA hartimi i programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile "Inxhinieri Ndërtimi", "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit" është realizuar sipas nevojave të tregut.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit mban komunikimi të ngushtë me kompanitë e ndërtimit që operojnë në treg, përmes një konsultimi të vazhdueshëm me to në lidhje me nevojat e tyre, mundësitë e reja dhe bashkëpunimin me to. Institucioni ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe të saj jashtë vendit si dhe me kompani vendase ose të huaja në të mirë të programit të studimit. Studimi i tregut dhe kuptimi i nevojave aktuale, janë përcaktues të kërkesave për prurje profesionale të fushave të Inxhinierisë së Ndërtimit, ndërsa IAL ofron kuadër profesional të fushave përkatëse të cilët mund t'i shërbejnë kërkesave të tregut të punës. Nëpërmjet Dekanit të Studentëve, Institucioni krijon marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të Inxhinierisë së Ndërtimit. Departamenti gjithashtu mbështet marrëdhëniet me kompanitë dhe punëdhënësit me anë të marrëveshjeve të ndërsjella. Kjo bazuar në statutin e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit</p> <p><i>Referencë: Annex1 – Statuti i IAL Epoka;</i> <i>Annex5-Strategjitë e IAL</i> <i>Annex 5.2 Mission of the study program</i> <i>Annex 5.1 Civil Engineering Strategic Plan</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e</p>	<p>Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile të Universitetit "EPOKA", është pjesë integrale e strategjisë së zhvillimit të Universitetit Epoka dhe ka të përcaktuara objektivat për edukimin e inxhinierëve duke u mbështetur në arritjet më të fundit shkencore në inxhinierinë e ndërtimit dhe në të njëjtën kohë duke shtuar kompetenca më të</p>

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>veçanta për studentët me njohurit e përgjithshme. Strategjia 2017-2022 e Universitetit EPOKA e zbërthyer në misionin, qëllimet, vizionin, burimet, arritjet e periudhës së fundit, fushat me prioritet sikur janë: sigurimi i cilësisë së lartë për mësimdhënie dhe nxënie, qëllimet e trajnimit të stafit akademik, etj janë pjesë e kurrikulës së masterit shkencor të inxhinierisë së ndërtimit dhe grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se ky program i studimit përputhet në plotëni me strategjinë e Institucionit.</p> <p><i>Referencë: Annex2 - Kurrikula e programit të studimit;</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Zbatimi i strategjisë zhvillimore, Statutit dhe Rregullores së Universitetit EPOKA ilustronet përmes programit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile. Gjithashtu edhe "Plani Strategjik i Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit 2017-2022". Ky program është hartuar në përputhje me fushat akademike dhe drejtimet e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë së ndërtimit. Për më tepër, merret në konsideratë niveli i kualifikimit i arritur dhe i përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (niveli 7 i KSHK-së).</p> <p><i>Referencë: Annex1 – Statuti i IAL Epoka; Annex5-Strategjitë e IAL</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Referuar kurrikulës së këtij programi studimi dhe studimit të tregut të punës, konstatohet që ajo është hartuar e tillë që të nxjerrë produkt sa më cilësor, ndërsa referuar angazhimit të studenteve të këtij PS konstatohet, që ata kanë kompetencën e duhur për të nxitur zhvillimin ekonomik kudo ku ata përfshihen. Fusha e Inxhinierisë së Ndërtimit është fushë mjaft e kërkuar në tregun e punës, për këtë arsye kurrikula e programit ofron lëndë të cilat synojnë jo vetëm ruajtjen e sigurisë por edhe zhvillimin ekonomik të vendit. Të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë janë themeluar mbi një plan të veçantë që synon pajisjen e studentëve me njohuritë e domosdoshme që kanë të bëjnë me profilet e kërkuara nga tregu i punës. Bazuar në mendimin e dekanit, ky program është menduar të jetë në harmoni me nevojat e tregut të punës të cilat përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit kanë evoluar me mjaft shpejtësi, sikurse edhe me ndryshimet më të fundit teknologjike, duke synuar që t'u mundësohet specialistëve të rinj bërja lehtësisht</p>

	<p>pjesë e këtij tregu. Programi i studimit përveç paisjes të studentëve me njohuritë e nevojshme shkencore teorike që lidhen me fushën e tyre të studimit, formon edhe shprehitë e nevojshme tekniko-praktike, duke i aftësuar të përballen e zgjidhin problematika të ndryshme inxhinierike, në funksion të plotë të zhvillimit ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p> <p><i>Referencë: Annex2 – Kurrikula e programit të studimit;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni ofron program studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Gjatë vizitës por dhe shqyrtimit të dokumentacionit u konstatua se Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profilet "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit", përputhet plotësisht me misionin dhe objektivat e Institucionit.</i></p> <p><i>GVJ konfirmon se Universiteti EPOKA, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, ka një strategji të zhvillimit për periudhën 2017-2022, e hartuar me profesionalizëm duke përfshirë çdo fushë e cila ka të bëjë me zhvillimin akademik shkencor, mësimdhënies, nxënies, dhe rritjes së cilësisë së produktit.</i></p> <p><i>Programi në fjalë është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore të tij, si dhe me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit EPOKA.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për	Njësia kryesore e Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, së bashku me njësinë bazë të DIN, mban përgjegjësinë për përmbushjen e detyrimeve ligjore për strukturën akademike dhe organizimin e programit studimor Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile. Kjo përfshin sigurimin e numrit

ofrimin e një programi studimi në atë fushë.

dhe nivelit të kërkuar të kualifikimit të personelit akademik, si dhe krijimin e marrëdhënieve të qarta midis personelit me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 56 pedagogë, nga të cilët 36 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 20 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë	
	PAE	PAK
Prof.Dr	4	-
Prof.Asoc	2	2
Dr/PhD	16	5
Msc	14	13
Gjithsej	36	20

Në nivel departamenti, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit për vitin akademik 2022 - 2023 ka:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	-
Prof.Asoc	2	1
Dr/PhD	3	-
Msc	1	3
Gjithsej	7	4

Në nivel program studimi, Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi për vitin akademik 2022-2023 ka:

Kualifikimi i stafit	Programi i studimit	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	-
Prof.Asoc	1	-
Dr/PhD	3	-
Msc	-	1

	Gjithsej	5	1
	<p>Gjithashtu IAL ofron edhe burimet e infrastrukturës në shërbim të programit të studimit. Burimet e infrastrukturës përfshijnë ambiente për studentë (Auditori/Klasë për leksione dhe seminare, Laborator për praktikë dhe orët laboratorike, Laboratorë Informatikë, Bibliotekë, Ambiente për fotokopje/librari, Zyra e Informimit të Studentëve, Zona Sociale dhe Sportive); Ambientet për personelin (Zyrat, Sallat e Takimeve, Ambientet për personelin e shërbimit, Ambientet e rekreacionit). Pjesë integrale e infrastrukturës është gjithashtu shërbimi ICTC ku IAL ofron një sërë programesh.</p> <p><i>Nga vizita në IAL dhe takimit me studentët, GVJ rekomandon që shërbimet mbështetëse si Bibloteka, kantina dhe laboratory të jenë të hapura dhe funksionale për studentët e masterit, duke parë oraret e tyre të studimit.</i></p> <p><i>Referencë: Annex28 – Infrastruktura në funksion të PS</i></p> <p><i>Tabelat përmbledhëse 1, 2, 6</i></p> <p><i>Annex 2.3 – CV e stafit akademik</i></p> <p><i>Annex 37 – ICTC në funksion të PS</i></p>		
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile të Universitetit "EPOKA" pjesë e FAI dhe DIN, është formuluar dhe miratuar në përputhje me misionin gjithëpërfshirës të Universitetit, "EPOKA". Vlen të përmendet se programi merr frymëzim nga misioni dhe ka ndërmarrë masa proaktive për t'u përafuar me të. Fakulteti është njësia kryesore akademike e Universitetit EPOKA, për të koordinuar mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fushat përkatëse të kërkimit mësimor. Universiteti përbëhet nga tre fakultete duke përfshirë Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, i cili përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Arkitekturës; 2. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit; 3. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike; 		

	<p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit është njësi bazë që koordinon programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi me profile. EPOKA është në proces të kodifikimit të të gjitha programeve të studimit që ofrohen aktualisht në të tre ciklet e studimeve.</p> <p><i>Referencë: Annex1 – Statuti i IAL Epoka;</i> <i>Annex5-Strategjitë e IAL</i> <i>Annex 9 – Skema e funksionimit të IAL</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave Inxhinieri Ndërtimi ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të departamentit. Universiteti “Epoka” është i organizuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</p> <p>Universiteti EPOKA ka stafin e tij të përhershëm akademik dhe ai me kontratë, administratën dhe menaxhmentin që janë të përkushtuar në respektimin e qëllimeve të përcaktuara qartë si dhe ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies duke synuar realizimin e objektivave nga strategjitë e tyre.</p> <p>Institucioni ka në strukturën organizative tri fakultete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë; 2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative; 3. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale; <p>Çdo Fakultet ka nga tre departamente. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ka Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Departamenti i Arkitekturës dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike.</p> <p><i>Annex 9 – Skema e funksionimit të IAL</i> <i>Annex2 – Kurrikula e programit të studimit;</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit,</p>	<p>NA</p>

cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.				
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Gjatë takimit me stafin akademik të PS, ku dy prej asistentëve ishin ish student, na u tha që IAL ofron trajnime për të diplomuarit. Gjithashtu stafi akademik na tha që gjatë muajit shtator janë realizuar një sërë trajnimesh për stafin lidhur me metodat e mësimdhënies dhe learning outcomes.</p> <p>Bazuar në tabelën përmbledhëse nr 6, IAL ka 22 marrëveshje bashkëpunimi të dedikuara për programin e studimit dhe shumë prej këtyre kompanive në fokusin e tyre kanë të mësuarit gjatë gjithë jetës, për rrjedhojë ata ofrojnë trajnime specifike për stafin dhe studentët e IAL, bazuar kjo në evidencat dhe në takimet e kryera me stafin dhe me studentët.</p> <p><i>Dokumentacion shtesë lidhur me trajnimet në IAL</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni është i organizuar në përputhje me aktet nënligjore në fuqi me qëllim përmbushjen e misionit të tij. Gjithashtu përmbushë standardet lidhur me organizimin e brendshëm të tij duke qenë pjesë përbërëse të tij tre Fakultete me përbërje nga tre departamente për secilin fakultet në veçanti, ndërsa të lidhura dhe funksionale me Administratë e cila ka njësitë e veta që janë në shërbim të përmbushjes së misionit të Universitetit përkatësisht të programit studimor Inxhinieri e Ndërtimit me profilet "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit".</i></p> <p><i>Standardi për numrin e personelit akademik të rregullt plotësohet dhe është i rregulluar me kontrata të rregullta pune duke respektuar të gjitha ligjet dhe normat ligjore në vend. Gjatë vizitës në institucion është vërejtur përkushtimi maksimal i stafit Akademik të rregullt për përmbushjen e misionit dhe objektivave për këtë program studimi "Inxhinieri Ndërtimi", kjo duke dëshmuar edhe sukseset e tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi RVB, si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton që Universiteti EPOKA ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitë kryesore e ato bazë brenda institucionit, duke siguruar një bashkëpunim funksionues. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë me njësitë kryesore (fakultetet). Në rastin konkret GVJ u informua për një sërë aktivitete me pjesëmarrje të studentëve e pedagogëve të tri njësive bazë të fakultetit. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas. Bashkëpunimi nuk është vetëm në nivel fakulteti por edhe në nivel universiteti. Ky element është i mirë sqaruar edhe në statutin e IAL ku cdo njësi ka detyra dhe objektiva të mirë përcaktuara</p> <p><i>Referencë: Raporti i vlerësimit të brendshëm;</i> <i>Annex 1 – Statuti i IAL</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Përveç gjetjeve në DVV, lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe, brenda e jashtë vendit, si dhe aktorët e biznesit, vendës e të huaj, në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e zyrës së projekteve e marrëdhënieve ndërkombëtare, ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet, duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme.</p> <p>Për hartimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit institucioni, nxit bashkëpunimin midis personelit brenda Universitetit EPOKA nëpërmjet shkëmbimit të informacionit,</p>

	<p>ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, duke siguruar një mënyre të garantuar për të pasur marrëdhënie eficiente bashkëpunimi.</p> <p>Po ashtu, Universiteti EPOKA ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj për realizimin e objektivave të programeve të studimeve duke siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron, për të organizuar trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit; dhe së fundmi duke raportuar analitikisht përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve. Në kuadër të projekteve Erasmus+, stafi dhe studentët kanë kryer mobilitete të shumta. Institucioni ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë dhe joarsimor vendas dhe të huaj. Në programin e studimit MSH në Inxhnieri Ndërtimi me profile, ndërkombëtarizimi është një prej shtyllave kryesore. Bashkëpunimi me institucionet joarsimore menaxhohet nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni për të udhëhequr dhe ndihmuar studentët në praktikën e tyre profesionale dhe mundësitë e karrierës</p> <p><i>Referencë: Raporti i vlerësimit të brendshëm;</i></p> <p><i>Annex – 10.1 – Plani strategjik për ndërkombëtarizim</i></p> <p><i>Annex – 22 – Marrëveshjet dypalëshe të IAL</i></p> <p><i>Annex – 21 – Lista e projekteve ku EPOKA është pjesë</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo</p>	<p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit kanë kontakte të vazhdueshme me kompanitë që operojnë në treg. Departamenti i IN ka nënshkruar marrëveshje me disa nga këto kompani. Pikat kryesore të këtyre marrëveshjeve janë praktika pune të studentëve, leksione të hapura, rastet studimore të tezës së studentit, aktivitete të kërkimit shkencor, etj. Institucioni ka një zyrë të dedikuar marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (ZMN) është në varësi të Zyrës së Rektorit në Universitetin “Epoka”. Detyra kryesore e</p>

<p>stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>kësaj zyre është zhvillimi dhe zbatimi i politikave ndërkombëtare dhe nxitja e procesit të ndërkombëtarizimit të universitetit.</p> <p>ZMN mbështet dhe garanton materializimin e politikave ndërkombëtare të universitetit në përputhje me objektivat strategjike dhe udhëzimet e përcaktuara nga Zyra e Rektorit dhe në konsultim me partnerët e fakultetit. Për të arritur qëllimet e lartpërmendura në kuadrin e ndërkombëtarizimit, ZMN mbështet koordinimin ndërkombëtar me institucionet e tjera dhe herë pas here e përfaqëson universitetin jashtë vendi dhe promovon imazhin ndërkombëtar të universitetit si një qendër globale e ekselencës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</p> <p>Misioni i Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare (ZMN) është që të krijojë kushtet e nevojshme për të promovuar dhe intensifikuar ndërkombëtarizimin e Universitetit “Epoka”.</p> <p>Mbështetur në dokumentacion e vënë në dispozicion konkludojmë se Universiteti EPOKA, është shumë i angazhuar në integrimin e aspekteve të formimit teorik, me atë kërkimor dhe praktik. Për këtë arsye janë ndërtuar marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me organizma të ndryshëm publik dhe privatë.</p> <p>Sikurse është përmendur edhe më lart kurrikula e programit është konceptuar duke u bazuar në informacionin e grumbulluar nga tregu i punës, kompanitë e ndryshme si dhe studimet e tjera çka është menduar për një program me fokus konkret, integrim në tregun e punës. Universiteti “Epoka” ndjek një politikë të favorshme për lëvizjen e studentëve në institucione arsimore të huaja me të cilat ka nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve organizohen konferenca të përbashkëta ndërkombëtare, projekte kërkimore, trajnime profesionale dhe praktika mësimore të studentëve.</p> <p><i>Referencë: Raporti i vlerësimit të brendshëm;</i> <i>Annex – 10.1 – Plani strategjik për ndërkombëtarizim</i> <i>Annex – 22 – Marrëveshjet dypalëshe të IAL</i> <i>Annex – 21 – Lista e projekteve ku EPOKA është pjesë</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e</p>	<p>Bazuar në DVV, GVJ mësoi se bashkëpunimi me punëdhënësit, për kryerjen e praktikave profesionale është vendosur përmes marrëveshjeve të shkruara, por jo detyruese. Çdo vit nga</p>

<p>studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit hartohet një raport vjetor në të cilin analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat, përfshirë këtu edhe ato në fushën e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Raporti vjetor përmbledh dhe analizon përfitimet e këtyre marrëveshjeve. Ky raport ndahet me të gjitha zyrat mbështetëse pranë rektoratit.</p> <p><i>Annex – 22 – Marrëveshjet dypalëshe të IAL</i></p> <p><i>Annex – 26 – Raporti vjetor 2021-2022</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit mban komunikimi të ngushtë me kompanitë e ndërtimit që operojnë në treg, përmes një konsultimi të vazhdueshëm me to në lidhje me nevojat e tyre, mundësitë e reja dhe bashkëpunimin me to.</i></p> <p><i>Institucioni ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe të saj jashtë vendit si dhe me kompani vendase ose të huaja në të mirë të programit të studimit. Studimi i tregut dhe kuptimi i nevojave aktuale, janë përcaktues të kërkesave për prurje profesionale të fushave të Inxhinierisë së Ndërtimit, ndërsa IAL ofron kuadër profesional të fushave përkatëse të cilët mund t'i shërbejnë kërkesave të tregut të punës. Nëpërmjet Dekanit të Studentëve, Institucioni krijon marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale të studentëve të Inxhinierisë së Ndërtimit. Departamenti gjithashtu mbështet marrëdhëniet me kompanitë dhe punëdhënësit me anë të marrëveshjeve të ndërsjella. Kjo bazuar në statutin e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga vizita në IAL dhe nga dokumentat e vënë në dispozicion GVJ konstaton se: Universiteti EPOKA vepron mbi bazën e një game të plotë rregullash e procedurash të përcaktuara në rregulloren e studimeve dhe provimeve të programit të ciklit të dytë për Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile. Të gjitha rregulloret janë të publikuara dhe i komunikohen gjithë stafit përmes formave zyrtare. Lloji i studimit të programit Master i Shkencave në Inxhinierinë e Ndërtimit është me kohë të plotë. Programi zhvillohet në gjuhën angleze.</p> <p>Programi përbëhet nga 13 lëndë, nga të cilat një praktikë profesionale (<i>element i cili tregon reflektimin kundrejt rekomandimeve të akreditimit të mëparshëm</i>), teza e masterit dhe lëndë. Cdo lëndë ka 7.5 ECTS përvec temës së masterit.</p> <p>Organizimi i mësimdhënies përbën shtyllën kryesore të Institucionit rreth së cilës mbështeten zhvillimet e aktiviteteve tjera shkencore, kërkimore për arritjen e objektivave të përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit. Instrumentet e mësimdhënies të cilat zbatohen në Universitetin EPOKA janë bashkëkohore duke numëruar pedagogët e moshës së re të cilët reflektojnë kreativitet gjatë procesit të mësimdhënies, përvojë të madhe profesionale të stafit të pedagogëve të angazhuar si dhe grada shkencore të cilat sigurojnë rezultate të kënaqshme në mësimdhënie.</p> <p>Metodat dhe teknikat e mësimdhënies të cilat zbatohen janë të shumëllojta, duke nxitur studentin në pjesëmarrje direkte aktive në mësim. Këto metodologji të mësimdhënies e vendosin pedagogun në rolin jo vetëm të lektorit por edhe të bashkëpunëtorit. Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit është një nga elementët më të rëndësishëm që ky program studimi ka dhe një nga mjetet më të mira mësimdhënëse dhe mësimnxënëse. Duke qenë Master i Shkencave komponenti aplikativ është shumë i rëndësishëm dhe studentët e prekin më nga afër</p>

	<p>nëpërmjet këtij laborator. Rekomandohet që të shfrytëzohet më shumë nga programi master i shkencave. Procesi i mësimdhënies përbëhet nga leksioni, projektet dhe detyrat e shtëpisë, praktikat, seminarët dhe laboratore të parashikuara në programin e lëndës. Vitit akademik fitohen 60 kredite ECTS. Diploma fitohet pas marrjes së paku 120 kredite (ECTS). Niveli i suksesit të studentit vlerësohet në bazë të provimeve në mes të semestrit; provimet finale, detyrat, prezantimet, projektet.</p> <p><i>Referencë: RVB, DVV</i></p> <p><i>Annex – Tabela 9 tek tabelat përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile jep njohuri të përparura në fushën e Inxhinierisë së ndërtimit. Lënda specifike CE 507 - Studim dhe Huluntim i Pavarur i Mbikëqyrur, është ajo që i fut studentët në të menduarin kritik kundrejt fushës së studimit. Lëndët e parashikuara të zhvillohen në programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi me profile janë të larmishme.</p> <p><u>Fillohet në vit të parë me CE 423- Planifikim projektit</u></p> <p>CE 435- Strukturat e betonit të përforcuar</p> <p>CE 548- Dinamika strukturore e ndërmjetme</p> <p>CE 419- Vlerësimi i ndërtimit të objektit</p> <p>CE 549- Qëndrueshmëria e betonit</p> <p>CE 452- Teknikat Statistikore në Hidrologji</p> <p>CE 442- Metodatat numerike të Avancuara</p> <p>CE 454- Materiale ndërtimi të avancuara</p> <p>CE 562- Aplikim Kompjuterik në Inxhinieri Ndërtimi</p> <p>CE 463- Bazat e Inxhinierisë së Lumenjve</p> <p>CE 555- Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmeteve</p> <p>CE 416- Menaxhimi i rrezikut në ndërtim</p> <p><u>Në vit të dytë vazhdohet me</u></p>

	<p>CE 503 – Metodatat e Kërkimit</p> <p>CE 507- Studim dhe Kërkim i Pavarur i Mbikëqyrur</p> <p>CE XXX Lëndë me Zgjedhje Teknike</p> <p>CE 500- Teza e Masterit</p> <p>CE 400 - Praktika profesionale</p> <p><i>Departamenti i ka propozuar institucionit që të bëjë ndryshime të kurrikulës me fokus uljen e krediteve ECTS për Tezën e masterit (CE 500) dhe shtimin e Praktikës Profesionale si lëndë e re e detyrueshme (Vendim nr.01, datë 28.04.2023, i Komitetit Shkencor të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit). Vendimi është miratuar nga senati akademik dhe do të hyjë në fuqi nga viti akademik 2023-2024</i></p> <p>Në total syllabuset e hartuara synojnë të rrisin aftësinë e studentëve të kuptojnë parimet e inxhinierisë gjeoteknike (sjellja e dherave), inxhinierisë së strukturave (analiza dhe projektimi i strukturave prej betoni të armuar dhe strukturat e çelikut, beton Special, restaurim dhe përforcim i strukturave), inxhinierisë së transportit (dyshemetë rugore, urat dhe tunelet), etj. Programi i studimit është Niveli 7 në Kornizën shqiptare të kualifikimeve dhe ai i përmbush të gjitha kriteret e këtij niveli.</p> <p><i>Referencë:</i></p> <p><i>Kurrikula e programit të studimit – Tabela 9, 10, 11</i></p> <p><i>Annex – 2.1 Kurrikula</i></p> <p><i>Annex – 2.2 Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Departamenti i ka propozuar institucionit që të bëjë ndryshime të kurrikulës me fokus uljen e krediteve ECTS për Tezën e masterit (CE 500), dhe shtimin e Praktikës Profesionale si lëndë e re e detyrueshme (Vendim nr.01, datë 28.04.2023. , i Komitetit Shkencor të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit). Vendimi është miratuar nga senati akademik dhe do të hyjë në fuqi nga viti akademik 2023-2024.</p> <p><i>Referencë: RVB</i></p>

<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Zyra për pranim është instanca e parë që një kantidat përballlet. Nëse ai pranohet duhet të plotësoj dosjen me dokumentacionin përkatës. Lista e dokumentacionit të regjistrimit e cila përmban: diplomë Universitare Bsc, transkripti i notave Bsc, diploma e shkollës së mesme dhe rezultati i maturës, Vetëdeklarata noteriale (mbi regjistrimin), CV-ja personale, Letër motivimi etj si dhe udhëzimet tjera për veprim të regjistrimit.</p> <p>Pranohen të regjistrohen në programin e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, shtetas shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë kushtet e vendosura nga IAL. Universiteti Epoka</p>

	<p>ndjek dhe zbaton të gjitha udhëzimet e misistrisë së arsimit dhe shkencës.</p> <p><i>Referencë: DVV, Vizita pranë sekretarisë mësimore ku u panë dosjet e studentëve</i></p> <p><i>Annex 17- Admission Criteria</i></p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>GVB gjatë shqyrtimit të DVV dhe vizitës në institucion, konstatoi që programi i studimit është i ngjashëm në masën 70% me programe të ngjashme studimi të ofruara nga insitucione të tjera në vënd. Kjo edhe falë bashkëpunimeve të shumta që Univesiteti EPOKA ka me IAL homologe brënda vëndit. Univesiteti EPOKA është në proces të kodifikimit të të gjitha programeve të studimit që ofrohen aktualisht në të tre ciklet e studimeve.</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Univesiteti EPOKA është në proces të kodifikimit të të gjitha programeve të studimit që ofrohen aktualisht në të tre ciklet e studimeve.</p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet vetëm nga Univesiteti EPOKA</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile është përmbajtjesor. Ky program studimi është i studiuar dhe i projektuar në mënyrë që të sigurojë një student / profesionist të përgatitur në aspektin teorik dhe cilësi profesionale për tregun e punës në vend dhe Europë.</i></p>

	<p><i>Përmbajtja e programit të studimit shkon për shtat me kërkesat aktuale të tregut të punës.</i></p> <p><i>Programi "Master i Shkencave" i ofruar nga Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka për qëllim të zgjerojë dijet e përftuara në ciklin e parë të studimit, i cili u jep studentëve aftësi të përgjithshme dhe profesionale që duhet të realizohen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij.</i></p> <p><i>Programi është hartuar në përputhje me politikat kombëtare të përcaktuara në planin strategjik për arsimin e lartë të Ministrisë së Arsimit, i ofruar në përputhje me nivelin e studimeve, dhe me qëllim që të arrihen dimensione ndërkombëtare, duke përfshirë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor, duke marrë në konsideratë nevojat e tregut të punës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit është pjesë përbërëse e Fakultetit të Inxhinierisë dhe Arkitekturës. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Institucioni, rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore. Departamenti plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25, të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë". Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës përbëhet nga tre njësi bazë;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Arkitekturës, 2. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike; 3. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit; <p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej</p>

56 pedagogë, nga të cilët 36 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 20 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë	
	PAE	PAK
Prof.Dr	4	-
Prof.Asoc	2	2
Dr/PhD	16	5
Msc	14	13
Gjithsej	36	20

Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Msc në "Inxhinieri Ndërtimi me profile", Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	1	-
Prof. Asoc.	2	-	2	-	1	-
Dr./PhD.	3	-	3	1	3	-
Msc.	-	-	1	-	-	1
Totali	5	0	6	1	5	1

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin

Njësia kryesore e Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, së bashku me njësinë bazë të DIN, mban përgjegjësinë për përmbushjen e detyrimeve ligjore për strukturën akademike dhe organizimin e programit studimor Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile. Kjo përfshin sigurimin e numrit dhe nivelit të kërkuar të kualifikimit të personelit akademik, si dhe krijimin e marrëdhënieve të qarta midis personelit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Bazuar në tabelën

e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	përmbledhëse <i>Tabela 1 dhe Tabela 2</i> , Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë për të tre vitet akademike nuk ka të angazhuar asnjë staf administrativ. <i>Tabelat përmbledhëse 1, 2, 6</i>								
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Bazuar në Statutin e Universitetit, Koordinatorin e programit të studimit është përgjegjësi i departamentit.								
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit zotëron informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, plani strategjik i universitetit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë.

	<p>Departamenti dhe cdo anëtar i personelit akademik/administrative ka akses të plotë tek dokumentat e sipërpërmendura. Cdo fillim semestri studentëve u vihen në dispozicion sylabuset dhe materialet e leximit. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit zotëron të gjithë informacionin në lidhje me kurrikulën dhe planprogramet e kurseve të profileve të programeve të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi (MSC CE). Të gjitha këto informacione janë të disponueshme në faqen zyrtare të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit</p> <p><i>Reference</i></p> <p><i>Annex 1 – Statuti</i></p> <p><i>Annex 1.2 – Regullorja</i></p> <p><i>Annex 2 - Kurrikula</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile është i strukturuar në 2 vite akademike dhe 4 semestra. Zhvillohen gjithsej 13 lëndë praktika profesionale dhe teza e diplomës, të ndara sipas 2 viteve akademike. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi ka katër (4) profile: Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit, Menaxhim i Ndërtimeve, Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit; dhe Inxhinieri e Resurseve Ujore. Profilet e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimore ofrojnë katër lëndë në dy semestrat e parë me shtatë pikë pesë (7.5) ECTS për çdo lëndë. Në semestrin e tretë, studentët ndjekin kurse për t'u përgatitur për tezën e masterit që do të merret në semestrin e katërt. Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p>
	<ul style="list-style-type: none"> - A - Lëndë Bazë 7.5 ECTS - B- Lëndë Karakterizuese 60 ECTS

	<ul style="list-style-type: none"> - C -Lëndë Ndërdisciplinore / Integruese 15 ECTS - D- Lëndë Plotësuese 12 ECTS - E - Detyrime Përmbyllëse 18ECTS <p>Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.</p> <p><i>Annex, Kurrikula (dokumentacion shtesë i vënë në dispozicion)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin. Institucioni, nëpërmjet zyrës së pranimeve, pajis studentët me të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranim, transfertë dhe njehësim studimesh. Të gjitha informacionet janë bërë publike dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të universitetit, si dhe janë të detajuara në rregulloren e programit të studimit. Gjithashtu, zyra e pranimit të studentëve ju jep të interesuarve të gjithë informacionet e nevojshme lidhur me regjistrim, transferim apo ekuivalentim. Të gjitha informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të Universitetit EPOKA.</p> <p><i>Annex 13 – Rregullorja e cilkit të dytë të studimit dhe regjistrimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Ndërtimi me Profile” përmban të gjithë informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit. Mënyra e vlerësimit të dijeve tregohet në rregulloren e PS. Mënyra e vlerësimit është e përcaktuar edhe në syllabus.</p> <p><i>Referencë: Annex 2.2- Syllabi of the program; Annex 2- Curricula of the study program, tabela përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe</p>	<p>Përmirësimi dhe përditësimi është një nga karakteristikat e Universitetit EPOKA. Cdo fund viti bëhet procesi i rishikimit të</p>

përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	kurrikulave dhe miratohen ndryshimet. Më i fundit ka qënë shtimi i praktikës profesionale. <i>Referencë: Annex 11- Politika për ndryshime të vazhdueshme; Annex 16.1 – NJSBC politika e cilësisë</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton që programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit. Programi i studimit është organizuar sipas kërkesave të të VKM Nr.41, datë 24.01.2018“Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Lëndët janë të grupuara sipas kategorive dhe përqindjeve të krediteve të Tabelës nr.1, shtojca 1, VKM nr.41, datë 24.01.2018</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. Tregu vendas është i etur për Inxhinier Ndërtimi, andaj ky program studimi nxit punësimin. Programi i studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile” zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të	Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat dhe veprimtaritë formuese që ofrohen mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit Msc në Inxhinieri Ndërtimi. Studimet në këtë cikël janë 120 ECTS të ndara në 4 semestra. Kjo ndarje mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit. Gjithashtu kontrolli

<p>programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>i vazhdueshëm i dijeve, praktika dhe seminarët risin mundësinë për të arritur objektivat formuese të studentit.</p> <p><i>Referencë: Annex – 2.2 Syllabuset e programit MSH Inxhinieri Ndërtimi;</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>Referencë: Annex – 2.2 Syllabuset e programit MSH Inxhinieri Ndërtimi;</i></p> <p><i>Annex – 2.3 – CV e stafit</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi zhvillohet në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile është i strukturuar në 2 vite akademike dhe 4 semestra. Zhvillohen gjithsej 13 lëndë praktika profesionale dhe teza e diplomës, të ndara sipas 2 viteve akademike. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Kurrikula e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi ka katër (4) profile: Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit, Menaxhim i Ndërtimeve, Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit; dhe Inxhinieri e Resurseve Ujore. Profilet e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimore ofrojnë katër lëndë në dy semestrat e parë me shtatë pikë pesë (7.5) ECTS për çdo lëndë. Në semestrin e tretë, studentët ndjekin kurse për t'u përgatitur për tezën e masterit që do të merret në semestrin e katërt.</p>

	<p>Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:</p> <p>A - Lëndë Bazë 7.5 ECTS</p> <p>B- Lëndë Karakterizuese 60 ECTS</p> <p>C -Lëndë Ndërdisciplinore / Integruese 15 ECTS</p> <p>D- Lëndë Plotësuese 12 ECTS</p> <p>E - Detyrime Përmyllëse 18 ECTS</p> <p>Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.</p> <p><i>Annex, 2.1 Kurrikula (dokumentacion shtesë i vënë në dispozicion)</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Departamenti përpiket dhe ka arritur të përditësojë lëndët dhe modulet në mënyrë të vazhdueshme, duke shtuar listën e literaturës së detyruar dhe ndihmëse në bibliotekën e institucionit, por edhe duke pasur si prioritet të vetin furnizimin e tyre me literaturë të 5 viteve të fundit.</p> <p>Literatura e përdorur në sylabuse është bashkëkohore. Programi i lëndëve dhe moduleve është përditësuar duke u bazuar në rekomandimet e akreditimit të fundit.</p> <p><i>Referencë: Annex 11- Politika për ndryshime të vazhdueshme;</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi ka katër (4) profile: Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit;, Menaxhim i Ndërtimeve, Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit; dhe Inxhinieri e Resurseve Ujore i ofron studentëve njohuri dhe dije specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të dytë të studimeve, duke tentuar të krijojë bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet praktikave.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me</p>	<p>Institucioni, Fakulteti dhe Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët e industrisë dhe tregun në përgjithësi, me qëllim evidentimin dhe inserimin në programin e studimit të lëndëve sipas nevojave dhe kërkesave të tregut. Universiteti EPOKA ka marrëveshje bashkëpunimi me</p>

prishmëritë e kërkesat e tregut e punës.	mbi 60 kompani, ndërsa ne bashkëpunojmë me mbi 110 kompani të tjera për vende të lira pune dhe mundësi praktike. Gjithashtu shumë prej studentëve të diplomuar nga ky program studimi kanë nderkur shkollën e doktoraturës pranë Universitetit EPOKA ose në Institucione të tjera brënda dhe jashtë vëndit. Kjo tregon që programi i studimit garanton vazhueshmëri akademike.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton që struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	IAL nëpërmjet zyrës së karrierës dhe Alumni kryen anketa dhe pyetësorë lidhur me cilësinë e programit të studimit në mënyrë që ti përshtaten sa më mirë tregut të punës. Gjatë zhvillimit dhe të kurrikulës PS Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi ka katër (4) profile: Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit; Menaxhim i Ndërtimeve, Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit; dhe Inxhinieri e Resurseve Ujore, njësitë përkatëse të angazhohen në konsultime dhe marrin në konsideratë rekomandimet e paraqitura nga institucionet partnere, alumni dhe aktorët e tjerë të tregut të punës. Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni (CPAO) nën Zyrën e Dekanatit të Zyrës së Studentëve (DOS) kryen një 'Anketë të Kënaqësisë së Kompanisë' që përmban disa pyetje në lidhje me kënaqësinë e studentëve gjatë punësimit të tyre dhe disa komente për përmirësimin e aftësive të të diplomuarve. Kjo bëhet për të rritur cilësinë e programit të studimit dhe për ta përafuar atë në mënyrë më efektive me nevojat e tregut të punës. Në takimet që pati GVJ me përgjegjësen e Departamentit, me NjSBC dhe

	<p>personelin akademik u informua për nevojat e ndryshimeve në kurrikulën e programit. Ata pohuan që këto nevoja lindin vazhdimisht në përgjigje të kërkesave të tregut vendas të punës dhe përjasjen sa më të mirë me programe të njejtë jashtë vendit dhe, ndryshimet e lejuara nën masën 20%, janë ndërmarrë herë pas here.</p> <p><i>Referencë: Annex 11- Politika për përmirësime të vazhdueshme; Annex 40 – Anketa e kënaqësive të kompanive</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Zyra e dekanit të studentëve është një instancë mjaft aktive në institucion, dhe si e tillë është pjesë integrale e përmirësimit të programeve të studimit dhe veçanërisht të programit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi ka katër (4) profile: Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit;, Menaxhim i Ndërtimeve, Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit; dhe Inxhinieri e Resurseve Ujore. Në përfundim të semestrit, çdo anëtar i fakultetit mbledh reagime dhe rekomandime nga studentët e tyre. Ne takimin me personelin e zyrën së Alumni-t GVJ u informua që Universiteti EPOKA mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin e sugjerimeve të tyre kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. Veçanërisht të dobishme ishin sugjerimet e të punësuarve jashtë vendit pasi transmetonin përvojën e tyre konkrete.</p> <p><i>Annex 50- Student Satisfaction Survey</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Institucioni është gjithmonë e gatshme të përshtas programet e studimit sipas nevojave kombëtare. Temat e masterit janë një mjet për të arritur këtë objektivë. Departamenti për udhëheqien e temave cakton drejtues të cilët janë me grada e tituj për të përmbushur më së miri objektivin e paracaktuar.</p> <p><i>Annex 13 regulation on second cycle study programs.</i></p>

Konkluzione	<i>GVJ konstaton që departamenti dhe fakulteti përmirësojnë veten e tyre në bazë të kërkesave të tregut dhe partnerëve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Institucioni ka objektiva të qarta përsa i përket kërkimit shkencor. Referuar planit strategjik të Universitetit EPOKA, lidhur me vizionin, prioritetet dhe objektivat strategjike, si edhe planin strategjik të njësisë bazë (Departamenti i Inxhierisë së Ndërtimit), GVJ konstaton që programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile, ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin e institucionit. PS plotëson të gjitha kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><i>Annex 13 regulation on second cycle study programs</i></p> <p><i>Annex 1- Statute of Epoka University</i></p> <p><i>Annex 1.1- Basic Regulation</i></p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	<p>Personeli akademik në Universitetin EPOKA ka liri akademike dhe gjithashtu bëhet pjesë e aktiviteteve artistike, punëve kërkimore etj, duke respektuar gjithnjë mësimdhënien. Departamenti i Inxhierisë së Ndërtimit ka krijuar një Komitet Shkencor për Programin Studimor të Masterit të Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, i cili përbëhet nga tre anëtarë të personelit akademik me të paktën titullin e doktoraturës. Komiteti Shkencor përgatit dhe propozon strategjinë e zhvillimit, planin dhe strukturën e studimit, programin e kërkimit shkencor dhe kriteret në bazë të të cilave pranohen studentët. Përgjegjësia për bashkërendimin e aktiviteteve shkencore është e koordinaorit të programit të studimit.</p> <p><i>Annex 13 regulation on second cycle study programs</i></p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Si të tilla janë Konferencat studentore dhe shkembimet e ndryshme ku studentët nxiten të marrin pjesë si dëgjues apo të prezantojnë punimet e tyre. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit cakton një Këshilltar në bazë të rregullores që lidhet me programin e studimit të ciklit të dytë. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit propozon aktivitete që synojnë përfshirjen e studentëve jo vetëm në organizim, por edhe pjesëmarrjen në këto aktivitete.</p> <p><i>Tabela përmbledhëse nr 5</i></p>			
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik na u tha që Institucioni stimulon stafin për aktivitete kërkimore dhe shkencore duke i përfshirë në aktivitete dhe projekte të ndryshme. Hulumtimi përfaqëson një nga aspektet kryesore të Universitetit EPOKA. Universiteti është i përkushtuar të krijojë kushte të favorshme për veprimtari shkencore dhe kërkimore dhe të ndihmojë stafin akademik në arritjen e rezultateve konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar brenda burimeve dhe instrumenteve që disponon institucioni. Stimulimi është në trajtë financiare dhe për rrjedhojë IAL është një nga institucionet me më së shumti publikime në revista me factor impakti. Ky kontribut nuk është vetëm për institucionin por rit ndjeshëm edhe ndikimin kombëtar. Institucioni është për tu vlerësuar lidhur me numrin dhe cilësinë e publikimeve.</p> <p><i>Annex 41- Regulation on Scientific Research</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konkludon që Univesiteti EPOKA është i mirë orientuar kundrejt kërkimit shkencor dhe këtë e demonstroi me publikime, pjesëmarrje dhe organizim aktiviteteve shkencore dhe gjithashtu me suportin që i jep stafit në këtë aspekt.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhnierisë është i angazhuar në mbështetjen e stafit akademik dhe projekteve shkencore kërkimore. Institucioni ka marrëveshje me institucione të tjera për realizimin e punëve kërkimore shkencore, duke vënë në dispozicion të dhëna dhe infrastrukturën që Institucioni disponon. Universiteti EPOKA ka një direktivë të shkruar dhe të publikuar me titull: “Për promovimin e botimeve shkencore” si dhe është krijuar Komisioni për Nxitjen e Botimeve dhe Mbështetjen e Veprimtarive Shkencore. Qëllimi i zyrës është të promovoj dhe motivoj angazhimin e stafit në kërkim shkencor.</p> <p><i>Annex 42- Common Guidelines for Scientific Research Proposal Submission.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti i Inxhnierisë së Ndërtimit angazhohet për tu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor e shkencor dhe angazhon stafin dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. Departamenti është i angazhuar gjithashtu në organizimin e Konferencave Shkencore Ndërkombëtare</p> <p><i>Annex 26- Department Annual Report 2021-2022.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Departamenti i Inxhnierisë së Ndërtimit, duke ecur në linjë me politikën e Universitetit EPOKA, mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Si të tilla janë aktivitetet shkencore ku studentët nxiten të marrin pjesë si dëgjues apo të prezantojnë punimet e tyre. Dy Konferencat e fundit të organizuara ishin në vitin 2020 dhe 2023.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit formon profesionist të gatshëm jo vetëm për tregun lokal por edhe atë të huaj. Këtë e dëshmon fakti që shumë prej ish studentëve janë të punësuar në profesion jashtë vëndit ose vazhdojnë studimet e doktoraturës.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e</p>	<p>Njësia përgjegjëse ndjek dhe zbaton të gjitha udhëzimet dhe rekomandimet kombëtare. Një e tillë është procesi i kodifikimit i cili po zhvillohet pranë IAL.</p>

nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<i>Referencë:</i> <i>RVB</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi plotëson të gjitha kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë” dhe akteve të tjera ligjore kombëtare në fuqi. <i>Referencë:</i> <i>RVB</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konsaton që programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor. Këtë fakt e tregon numri i lartë i publikimeve dhe cilësia e tyre. Gjithashtu organizimi i aktiviteteve kërkimore shkencore që IAL dhe departamenti marrin pjesë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

37

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ mbështetur në DVV të Universitetit EPOKA” si dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, konstaton se në strategjinë e institucionit, janë përcaktuar si qëllime prioritare përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies. Gjithashtu institucioni zhvillon trajnime të vazhdueshme për të përmbushur këtë qëllim. Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, labororet, praktikat mësimore e profesionale, etj.</p> <p>Ndarja e tyre në program është si më poshtë:</p> <p><u>Orë totale në auditor për profilin Inxhinieri e Strukturave të ndërtimit;</u></p> <p>Leksione 900 orë</p> <p>Seminare 675 orë</p> <p>Ushtrime/Laboratorë - 225 orë</p> <p>Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor - 10 orë</p> <p>Praktikë profesionale - 1 orë</p> <p>Diploma/Provim Formimi 1 orë</p> <p>Në total 1812 orë</p> <p><u>Orë totale në auditor për profilin Menaxhim i Ndërtimit</u></p> <p>Leksione 900 orë</p> <p>Seminare 675 orë</p> <p>Ushtrime/Laboratorë - 225</p> <p>Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor - 10 orë</p> <p>Praktikë profesionale - 1 orë</p> <p>Diploma/Provim Formimi 1 orë</p>
	<p>Praktikë profesionale - 1 orë</p> <p>Diploma/Provim Formimi 1 orë</p>

	<p>Në total 1812 orë</p> <p><u>Orë totale në auditor për profilin Materiale Ndërtimi</u></p> <p>Leksione 900 orë</p> <p>Seminare 600 orë</p> <p>Ushtrime/Laboratorë - 300 orë</p> <p>Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor - 10 orë</p> <p>Praktikë profesionale - 1 orë</p> <p>Diploma/Provim Formimi 1 orë</p> <p>Në total 1812 orë</p> <p><u>Orë totale në auditor për profilin Inxhnieri e Resurseve Ujore</u></p> <p>Leksione 900 orë</p> <p>Seminare 675 orë</p> <p>Ushtrime/Laboratorë - 225 orë</p> <p>Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor - 10 orë</p> <p>Praktikë profesionale - 1 orë</p> <p>Diploma/Provim Formimi 1 orë</p> <p>Në total 1812 orë</p> <p><i>Annex – Tabela 13 tek tabelat e përditësuara</i></p> <p><i>Annex – 2.1 Kurrikula</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Mësimdhënia në Universitetin “EPOKA”, rezulton e larmishme, në varësi të specifikave të lëndëve dhe nevojave të studentëve. Ofrohen mundësi të barabarta për të gjithë studentët, pavarësisht nivelit të përgatitjes së tyre. Format e mësimdhënies mbajnë parasysh rezultatet e vlerësimeve të ndryshme, të kryera herëpashere. Në procesin e mësimdhënies në programin e studimit përdor mjetet audio vizive të teknologjisë për realizimin e orëve mësimore. Staf i akademik inkurajon dhe mbështet studentët që të përdorin dhe të mësojnë</p>

	<p>Softëare dhe programe për të zhvilluar vlerësimet dhe projektet për klasat e tyre. Stafit akademik përdor metoda të ndryshme si: Ndarja e studentëve në grupe për projekte për t'u mësuar atyre aftësitë përmes bashkëpunimit. Format e mësimdhënies shkojnë në linjë me learning outcomes të specifikuar në syllabus. IAL ka në dispozicion të programit të studimit edhe një laborator materialesh ndërtimi i cili lehtëson procesin e mësim nxënies</p> <p><i>Referencë:</i></p> <p><i>RVB dhe vizita ne IAL</i></p> <p><i>Annex 43- Guideline On the conduct of teaching and other activities during the 2020-2021 fall semester</i></p> <p><i>Annex 5.2 Mission of the study program</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.</p>	<p>Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe Workshope me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme. Një shembull është “Trajnimi për Edukimin Dixhital” në shtator 2019 i organizuar nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Përballë një brezi të ri studentësh të aftë për teknologjinë, përfaqësuesit e shtëpisë botuese ndërkombëtare "Pearson" prezantuan dhe trajnuan stafin me platformën e tyre të personalizuar. Pjesë tjetër e mbështetjes së IAL është edhe nxitja financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe publikime të ndryshme, të cilat ndikojnë drejt për së drejti me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo mbështetje demonstron përmes vendosjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucional me institucionet homologe vendase dhe të huaja. Fokusi kryesor i këtyre marrëveshjeve përfshin disa fusha kyçe, duke përfshirë shkëmbimin e stafit akademik me qëllim të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore. Përveç kësaj, këto marrëveshje gjithashtu lehtësojnë promovimin dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, si dhe organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, shkëmbimit të materialeve akademike dhe literaturës shkencore. Mundësi të tjera janë programi Erasmus + për shkëmbimin e stafit ku stafi akademik mund të përfitojë</p>

	<p>nga mundësitë që këto përvoja japin për të përmirësuar kompetencat e tyre didaktike. Nga takimi që GVJ pati me zyrën e projekteve, na u konfirmua që 4 staf nga Departamenti i Inxhnierisë së Ndërtimit kanë qënë pjesë e mobiliteteve ndërkombëtare, 3 staf kanë ardhur, 0 student kanë shkuar si rezultat i mos ofrimit të programit në anglisht në instituiconet partnere.</p> <p><i>Referencë:</i></p> <p><i>RVB dhe vizita ne IAL</i></p> <p><i>Annex 8.2- List of Training Activities</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie. Stafi ka ekspertizën e duhur për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Gjithashtu, gjatë vizitës në universitet, u diskutua mbi shpërndarjen e ngarkesës tek stafi akademik. Të gjithë profesorët japin lëndë të cialt janë ngushtësisht të lidhura me fushat e tyre të ekspertizës. Të gjithë profesorët japin lëndë të cialt janë ngushtësisht të lidhura me fushat e tyre të ekspertizës. Kjo gjë vlerësohet shumë edhe nga studentët të cilët u shprehën që një nga elementët më të mirë të programit të studimit është stafi akademi, përgatitja dhe angazimi i tyre. GVJ gjatë vizitës në institucion dhe nga bisedat me studentin konstatoi se metodat e mësimdhënies janë të larmishme, duke u përpjekur të përfshijnë studentët sa më shumë në diskutime dhe zgjidhje të situatave konkrete.</p> <p><i>Annex 2.3- CV staff</i></p> <p><i>Annex 7- Regulation_Staff_Recruitment</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Nëpërmjet mënyrave të ndryshme (plotësimi i pyetësore të vlerësimit) Universiteti EPOKA thith mendimet dhe sugjerimet e studentëve në lidhje me problematikat e procesit mësimor. Pas kësaj instancat administrative të IAL kryejn verifikimet përkatëse dhe propozon masat përkatëse, të cilat konsistojnë në ndryshimin e trajnime lidhur me mësim dhënien apo të zëvendësimit të pedagogut, i cili nuk e ka kompetencën e duhur profesionale dhe didaktike. Kjo na u vërtetua nga zyra e NJSBC gjatë takimit në IAL. Bazuar në <i>Annexin 12</i>, Vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet: Pyetësorit të studentit i</p>

	<p>cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie. Ky pyetësor ka 14 pyetje dhe është i detyrueshëm të plotësohet nga studentët. Rezultatet e vlerësimit i jepen secilit pedagog pas publikimit të notave përfundimtare</p> <p><i>Annex 12- Directive Acad Admin Perfor Assess _ Quality Improv</i></p> <p><i>Annex 12.1 Academic Performance Measurement and Assessment Form</i></p> <p><i>Annex 12.2- Course Instructor Evaluation Survey</i></p> <p><i>Annex 12.3 Course Instructor Evaluation Survey</i></p> <p><i>Annex 1 Statuti i Universitetit EPOKA</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Universiteti EPOKA, në përputhje me legjislacionin e arsimit të lartë ka krijuar komisionin e sigurimit të brendshëm të cilësisë si një strukturë autonome dhe përhershme. Organi që punon për ofrimin e monitorimit dhe mbështetjes në promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie është Departamenti përgjegjës për programin e studimit, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, me nënjesitë e tij si Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve dhe Akademik. Bordi i Vlerësimit të Performancës dhe Përmirësimit të Cilësisë. Këto organe zhvillojnë mekanizma cilësorë për të kontrolluar mjedisin mësimor në Universitet. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore, duke propozuar ndryshime dhe përmirësime, të cilat i gjykon të arsyeshme. Komisioni bashkëpunon dhe bashkëvepron me njësitë kryesore dhe bazë për rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Universiteti EPOKA ka hartuar edhe një manual për sigurimin e brendshëm të cilësisë. IAL ka një politikë të mirëstrukturuar dhe të institucionalizuar të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm IAL ka zhvilluar një sërë trajnimesh lidhur me metodat inovative dhe sigurimin e cilësisë.</p>

	<i>Annex 11- Policy on Continuous Improvement of Study Program</i> <i>Annex 16 Quality Assurance Handbook.</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti EPOKA garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metoda e praktikë funksionale që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Gjithçka i bëhet e qartë studentit gjatë javës së orientimit, si edhe nga pedagogët e lëndëve. Udhëzuesi i studentëve është dokumenti përmbledhës për të gjithë procesin e studimit në Universitetin Epoka. <i>Annex 30- Student_Guide_2022_2023</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në javën e parë të semestrit akademik studentët njihen me programin e lëndës, përmbajtjen e saj, si edhe formën e vlerësimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në çdo silabus, përcaktohet edhe vlerësimi i studentëve. Syllabusi i plotë shpallet në Sistemin Interaktiv Epoka. Studentët mund të kenë akses në të gjitha programet mësimore ose nga faqja e internetit e departamentit ose përmes llogarisë së tyre studentore në Sistemin Interaktiv EPOKA (EIS). <i>Annex 30- Student_Guide_2022_2023</i> <i>Annex 2 – Syllabus</i>

<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Duke iu referuar DVV, syllabuseve të lëndëve si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në instutcion rezulton, se për të gjitha lëndët vlerësimi është gjithësemestral dhe përfshin forma të ndryshme vlerësimi. Kjo realizohet përmes njëmbëdhjetë kritereve të ndryshme që janë: (1) detyrat e shtëpisë, (2) provimi i mesëm, (3) prezantimi, (4) projekti, (5) kuizi, (6) laborator, (7) provimet laboratorike/praktike, (8) studim rasti, (9) punim terminal, (10) provim përfundimtar dhe (11) pjesëmarrje. GVJ është e mendimit se këto forma të ndryshme vlerësimi, nxisin angazhimin e studentit, dhe janë në përputhje me diversitetin e studentëve dhe të nivelit të tyre të angazhimit.</p> <p><i>Annex 13- regulation on second cycle study programs</i></p> <p><i>Annex 13.1 – 13.4</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se: Kuadri rregullator i IAL përfshin forma të ndryshme kontrolli dhe vlerësimi të cilat u bëhen me dije studentëve para fillimit të lëndës.</i></p> <p><i>Këto forma të ndryshme kontrolli garantojnë një shpërndarje dhe mbulim të mirë të vlerësimit të çdo studenti në këtë program studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.3</p> <p>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Gjithçka i bëhet e qartë studentit gjatë javës së orientimit, si edhe nga pedagogët e lëndëve. Duke iu referuar DVV, syllabuseve të lëndëve si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në instutcion rezulton, se për të gjitha lëndët vlerësimi është gjithësemestral dhe përfshin forma të ndryshme</p>

<p>lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>vlerësimi, si projekte, pjesëmarrje, provim i ndërmjetëm dhe final etj. Në çdo lëndë bëhet edhe një kontroll me shkrim i ndërmjetëm, në javën e 7 ose të 8 të semestrit. Në përgjithësi, ekzistojnë dy korniza kohore të dedikuara për provimet afatmesme (java e 8-të e semestrit) dhe provimet përfundimtare (java 15 dhe 16 - dy javët e fundit të semestrit).</p> <p>GVJ është e mendimit se këto forma të ndryshme vlerësimi, nxisin angazhimin e studentit, dhe janë në përputhje me diversitetin e studentëve dhe të nivelit të tyre të angazhimit</p> <p><i>Annex 2.2- Plan programi</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Sisteme elektronike të testimit janë përdorur gjatë periudhës së pandemisë. Me kalimin e kësaj periudhe testimi i studentëve kryhet me metoda klasike. Për studentin e programit MSh “në Inxhinierinë e Ndërtimit” me profile, të gjitha provimet janë kryer fizikisht në klasë. Në kuadër të transparencës të gjitha notat futen në systemin EIS dhe janë të aksesueshme nga studentët. Provimet janë anonime dhe për këtë ka një procedurë të dedikuar. Institucioni ka siguruar infrastrukturë të mjaftueshme për zhvillimin e provimeve në anonimat të plotë. Aplikohet sekretimi i fletëve të provimit, mbikqyrja e sallave nga pedagogë të caktuar. Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen me procedurë sekretimi deri sa dorëzohen në sekretari. Bazuar në udhëzuesin për provime.</p> <p><i>Annex 13 – Udhëzues për provimet</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive kryhet nga pedagogu i lëndës ose në raste të vecanta nga komisioni i dedikuar bazuar kjo në DVV. IAL ka një bord provimi të dedikuar i cili ndjek procesin dhe siguron cilësinë e duhur.</p> <p><i>Annex 13 – Udhëzues për provimet</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit, rezultoi se tezat e provimit, përveç vlerësimit me pikë për seksionet e ndryshme, ata i shoqërojnë ato me komente rreth saktësisë së përgjigjeve, orientuese për riprovimet, por edhe për të pasur një proces objektiv dhe të argumentuar vlerësimi.</p>

<p>nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Universiteti, nëpërmjet rregulloreve të tij, dënon reptësisht kopjen dhe plagjiaturën. Gjatë zhvillimit të provimeve salla monitorohet nga dy apo më shumë pedagogë të caktuar e të miratuar nga drejtuesi i departamentit. Bazuar në RVB, përveç rregullores së shkruar, universiteti përdor programin Turnitin si një mekanizëm që kontrollon plagjiaturën për punimet e studentëve.</p> <p><i>Annex 28 - Infrastruktura IT në funksion të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qarte dhe të shpallura. Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen në meritën e studentëve. Bazuar kjo në takimin me studentët.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët rezultoi se ata informohen për vlerësimin nëpërmjet sistemit EIS, mbasi ata kanë plotësuar anketën për vlerësimin e pedagogut. Studentët informohen në syllabusin e lëndës, në rregulloren e provimeve si dhe nga guida e studentit. Të tre këto dokumenta janë të publikuar edhe në faqen zyrtare të internet.</p> <p><i>Annex – 2.2 Syllabuset e lëndëve</i> <i>Annex 13 – Rregullore e programit</i> <i>Annex 15 – Kërkesat e studentëve lidhur me notat</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit ngrihet një komision vlerësimi i përbërë nga pedagogë, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vlerësimi që bën komisioni, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar</p>

	<i>Annex 30 – Udhëzuesi i studentëve të Universitetit EPOKA</i> <i>Annex 13.5 - Direktiva e Universitetit EPOKA “Për Funksionimin e Bordit të Provimeve</i>			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbljedhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti EPOKA siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo student duke përfshirë edhe procesin e ankimimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Inxhnieri Ndërtimi me profile i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të studimeve. Krahas njohurive teorike, programi synon mbi të gjitha aftësimin praktik të studentëve. Gjatë viteve të ekzistencës së programit të studimit janë diplomuar dhjetra studentë që janë punësuar edhe në tregun e brendshëm edhe atë jashtëm të punës. GVJ shqyrtoi kurrikulën e këtij program dhe konstaton që ajo është e ngjashme me programe të tjera të këtij karakteri brenda e jashtë vendit. Bazuar në të gjitha këto GVJ vlerëson plotësimin e këtij kriteri. <i>Annex – 2.2 Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit nuk ofron lëndë specifike lidhur me teknologjinë e informacionit, shkencave humane sociale apo komunikimin. Por bazuar në sylabuset e paraqitura nga IAL, disa nga këto komponent përfshihen në lëndë të tjera si përshebull lënda CE 562 Aplikim Kompjuterik në Inxhinieri Ndërtimi (Kategoria B); Metodatat e Kërkimit CE 503 (Kategoria B), CE 442 Metodatat Numerike të Avancuara (Kategoria A) dhe Kursi i Praktikës Profesionale

	<i>Annex – 2.2 Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe silabuset e çdo lënde, analizohen në përfundim të semestrit akademik. Pedagogët tërheqin mendimin e studentëve për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të përmbajtjes së lëndëve. Si një test për të kuptuar se sa kanë përfituar studentët shërben edhe detyra e kursit apo detyra praktike, që realizohet në fund të lëndës. Në nivel institucional Universiteti EPOKA e rregullon këtë proces nëpërmjet direktivës “Për funksionimin e Bordit të provimeve” ku cdo fakultet cakton një ekspert për të vlerësuar cilësinë e provimeve</p> <p><i>Annex 30 – Udhëzuesi i studentëve të Universitetit EPOKA</i></p> <p><i>Annex 13.5 - Direktiva e Universitetit EPOKA “Për Funksionimin e Bordit të Provimeve</i></p>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat janë të mirëpercaktuara në programet lëndore. Studentët e programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi me profile kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët, si dhe në praktikat profesionale. Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit ka marrëveshje dypalëshe shkëmbimi me universitete shumë prestigjioze në Evropë si Universiteti i Barit, Itali, Universiteti Vigo, Spanjë, Universiteti Iasi, Rumani etj. Stafi akademik dhe studentët e universiteteve partnere dhe departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit shkëmbejnë rregullisht.</p> <p><i>Annex 22 – Lista e mobiliteteve dhe partneriteteve</i></p> <p><i>Anex 2 – Plan program i lëndëve</i></p>

<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të projekteve ndërkombëtare capacity building, shumë staf i huaj i bashkohet institucionit për zhvillimin e leksioneve të hapura dhe për sjelljen e eksperiencave të reja brenda programit të studimit.</p> <p><i>Annex 22 – Lista e mobiliteteve dhe partneriteteve</i></p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga vizita në universitet konstatohet se IAL inkurajon zhvillimin e ideve inovative të stafit dhe studentëve, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Universiteti u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera, duke i mbështetur ato edhe financiarisht. Një shëmbull konkret ka qënë konferenca “4th International balkans conference on challenges of civil engineering” e organizuar nga departamenti i inxhinierisë së ndërtimit</p> <p><i>Referencë</i></p> <p><i>RVB</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Të gjitha informacionet lidhur me diplomimin janë publike në faqen e internetit dhe gjithashtu në lëndën e diplomës “Supervised Independent Studies”.</p> <p><i>Annex 44 – Model teze diplome</i></p> <p><i>Annex 13 – Rregullore e ciklit të dytë</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Informacioni dhe udhëzimet mbi përgatitjen dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është i publikuar. Të gjitha procedurat që ndiqen janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit dhe të programit të studimit. Nga vizita në universitet, vërehet që studentët përzgjedhin udhëheqësin sipas fushave të interesit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ata të kryejnë punën e tyre kërkimore shkencore, në kuadër të lëndës “Supervised Independent Studies”.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në rastin e studentëve të prograimit MSH në Inxhnieri Ndërtimi me profile detyrimet përmbyllëse realizohen vetëm nëpërmjet mbrojtjes së tezës së diplomës.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL dhe takimit me studentin, GVJ u informua që personeli akademi e orienton studentin në përcaktimin e temës së diplomës.</p>

rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Universiteti EPOKA vë në dispozicion të gjithë infrastrukturën e nevojshme për kryerjen e testeve apo analizave të ndryshme pasi IAL zotëron një laborator shumë të pasur për testime. Gjithashtu IAL ka një bibliotekë shumë të zgjeruar dhe është e abonuar në JSTOR. <i>Referencë: Annex28 – Infrastruktura në funksion të PS</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Punimi i diplomës vlerësohet me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Komisioni përbëhet nga tre antarë. <i>Annex 46 - Raporti i Provimit të Tezës për Studentët Master</i> <i>Annex 3 - Rregullores për 'Programet e Studimit të Ciklit të Dytë'</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. <i>Annex 14 - Për Modelin e Diplomës dhe Modelin e Shtojcës së Diplomës</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ka krijuar një bazë të dhënash të plotë për të gjithë procesin mësimor në vite. Dokumentacioni ruhet për një periudhë pa afat. Të dhënat statistikore përpunohen periodikisht sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, agjencisë së sigurimit të cilësisës, apo të vetë institucionit. <i>Referencë - RVB</i>

Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbljedhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti EPOKA ndjek një politikë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në PS Master në Inxhnieri Ndërtimi dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Infrastruktura dhe mjediset e Universitetit Epoka plotësojnë kërkesat për zhvillimin normal të procesit mësimor për programin e studimit Master i Shkencave në Inxhnieri Ndërtimi me profile. Laboratori i inxhinierisë së ndërtimit është i pajisur me mjetet e nevojshme për kryerjen e orëve laboratorike. Po ashtu laboratorët janë të pajisur me kompjuterë dhe softuerë të nevojshëm për zhvillimin e gjithë procesit mësimor. Përveç sa më sipër IAL ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione që suportojnë zhvillimin e praktikave. Edhe pse është program Master shkencor, IAL e përmbush kriterin <i>Annex 28 - Infrastruktura IT në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nga vizita në IAL dhe takimi me studentët, GVJ u informua që studentët e programit të studimit kryen praktikën profesionale nën mbikqyrjen e stafit përkatës pranë kompanive të ndërtimit.

Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale është e detyrueshme dhe vlerësohet me kredite. Për më tepër kërkohet një vlerësim narrativ mbi performancën e studentit gjatë praktikës.			
Konkluzione	GVJ konstaton që IAL ndjek procedurë të saktë për kryerjen e praktikave profesionale			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit	Në konsultim të dokumentacionit të DVV, takimit me personelin akademik si dhe takimit me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore. GVJ konstatoi që personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, i angazhuar në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Ai ka nivelin e duhur të kualifikimit për drejtimin e PS, Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile". Personeli akademik i angazhuar me këtë PS mbulonte të gjitha lëndët/modulet mësimore të programit. I gjithë aktiviteti i tij

akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

shkencor lidhej me fushën kërkimore të programit të studimit. Konkretisht, për PS “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile”, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit kishte angazhuar, sipas viteve, personelin akademik si më poshtë:

1. Për vitin akademik 2018- 2019 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 6 pedagogë nga të cilët 6 PAE dhe 0 PAK (100 % / 0 %);
2. Për vitin akademik 2019- 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 5 pedagogë nga të cilët 5 PAE dhe 0 PAK (100 % / 0 %);
3. Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 5 pedagogë nga të cilët 5 PAE dhe 0 PAK (100 % / 0 %);
4. Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 7 pedagogë nga të cilët 6 PAE dhe 1 PAK (85 % / 25 %);
5. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 6 pedagogë nga të cilët 5 PAE dhe 1 PAK (85 % / 25 %):

Tituj/ grada	2018-2019		2019-2020		2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-
Prof. Asoc.	2	-	2	-	2	-	2	-	1	-
Dr./PhD.	4	-	3	-	3	-	3	1	3	-
Msc.	-	-	-	-	-	-	1	-	-	1
Totali	6	0	5	0	5	0	6	1	5	1

Referenca:

-RVB

-Shënime nga vizita në Institucion

-Shtojca 7 “Rregullore e rekrutimit të stafit”

	- https://www.epoka.edu.al/
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile” zhvillohet në 2 vite shkollorë (4 semestra). Plani mësimor përmban gjithsej 13 lëndë+ praktika profesionale + teza e diplomës. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Ngarkesa e përgjithshme që duhet të përballojë personeli akademik efektiv sipas profileve është:</p> <p>për profilin Inxhinieri e Strukturave të ndërtimit</p> <p>Leksione 900</p> <p>Seminare 675</p> <p>Ushtrime/Laboratorë 225</p> <p>Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor 10</p> <p>Praktikë profesionale 1</p> <p>Diploma/Provim Formimi 1</p> <p>Në total 1812</p> <p>për profilin Menaxhim i Ndërtimit</p> <p>Leksione 900</p> <p>Seminare 675</p> <p>Ushtrime/Laboratorë 225</p> <p>Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor 10</p> <p>Praktikë profesionale 1</p> <p>Diploma/Provim Formimi 1</p> <p>Në total 1812</p> <p>për profilin Materiale Ndërtimi</p> <p>Leksione 900</p> <p>Seminare 600</p> <p>Ushtrime/Laboratorë 300</p> <p>Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor 10</p>

	<p>Praktikë profesionale 1</p> <p>Diploma/Provim Formimi 1</p> <p>Në total 1812</p> <p>për profilin Inxhnieri e Resurseve Ujore</p> <p>Leksione 900</p> <p>Seminare 675</p> <p>Ushtrime/Laboratorë 225</p> <p>Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor 10</p> <p>Praktikë profesionale 1</p> <p>Diploma/Provim Formimit 1</p> <p>Në total 1812</p> <p>Referuar numrit të përgjithshëm të PAE (6) dhe ngarkesës prej gjithsejt 1812 orë për profil, GVJ gjykon që ngarkesa mësimore mbulohet në përputhje me komizën ligjore në fuqi (UDHËZIM NR. 29, DATË 10.09.2018 PËR VEPRIMTARINË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË)</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Tabelat përmbledhëse -Shtojca 47 "Direktiva për ngarkesën mësimore" - https://www.epoka.edu.al/
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin</p>	<p>Referuar numrit të stafit të angazhuar për këtë PS gjatë viteve 2019-2023 konstatohet që për vitin 2019-2020 dhe 2020-2021 kanë qenë 5 PAE+PAK, për vitin 2021-2022 kanë qenë 7 PAE+PAK ndërsa për vitin 2022-2023 6 PAE+PAK. Siç shihet numri i PAE+PAK është rritur në vitin 2021-2022 me 2 persona dhe është zvogëluar me 1 person në vitin 2022-2023 në krahasim me vitin 2021-2022.</p> <p><u>GVJ rekomandon</u> që në interes të PS do të duhej që ky numër të stabilizohej për të mos patur shumë balancime në shpërndarjen e ngarkesës. Gjtë vizitës në zyrën e burimeve njerzore GVJ konsultoi</p>

<p>me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>dosjet e personelit dhe gjeti që ato ishin të plota konform kërkesave ligjore.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>-Tabelat përmbledhëse</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në materialet e DVV, vizitën në zyrën e burimeve njerzore, takimin me personelin akademik dhe konsultimin e faqes zyrtare në internet të Universitetit Epoka https://www.epoka.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html,</p> <p>GVJ konstaton që në këtë IAL ndiqen të gjitha procedurat ligjore të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit, të cilat garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>-Shtojca 7 “Rregullorja për rekrutim stafi”</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Referuar CV-ve të personelit ndihmës akademik të angazhuar me PS, Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile”, ngarkesës në syllabuset e lëndëve përkatësisht moduleve, aktiviteteve mësimore dhe vizitave në auditoret dhe laboratorin ku zhvillohet procesi mësimor, GVJ konstaton që universiteti Epoka siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>-Shtojca 7 “Rregullorja për rekrutim stafi”</p>

	- https://www.epoka.edu.al/
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin çdo vit akademik të të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile” në universitetin Epoka, është përgjegjëse zyra e Burimeve Njerzore, e cila nëpërmjet “formularit informativ të Stafit”, që plotësohet nga çdo antar i tij, disponon të dhënat e kërkuara. Kjo bëhet duke respektuar udhëzimet e komisionerit public “Për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale”. Ruajtja e të dhënave organizohet duke mbajtur dosje fizike për çdo antar të personelit si dhe dosje elektronike në sistemin interaktiv Epoka (https://eis.epoka.edu.al/login). GVJ i konsultoi burimet e të dhënave për këtë kriter dhe konstaton plotësimin e tij.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- Annex 31- Staf_Guide_2022_2023</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues të biznesit e kompanive për realizimin e praktikave profesionale në universitetin Epoka organizohet e drejtohet nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumni. Gjatë vizitës në këtë zyrë, GVJ konstaton që institucioni vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale dhe punimin e diplomës. Konkretisht Departamenti cakton staf mbikëqyrës si për praktikën ashtu edhe për punimin e diplomës, mbështetur në rregulloren për PS e ciklit të dytë. GVJ, duke marrë në konsideratë përfshirjen e praktikës profesionale si lëndë e detyruar në PS “Master shkencor në inxhinieri ndërtimi me profile” rekomandon hartimin e një procedure (rregulloreje) të veçantë për organizimin, kryerjen dhe kontrollin e praktikës profesionale.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p>

	<p>- Annex 31- Staf_Guide_2022_2023</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Për PS “Master shkencor në inxhinieri ndërtimi me profile” deri më tani nuk ka procedurë lidhur me realizimin e praktikave profesionale, pasi kjo lëndë nuk ka qenë e përfshirë në planin mësimor. Me rekomandimin e GVJ në akreditimin e mëparshëm të këtij PS, senati në muajin maj 2023 miratoi vendimin për aprovimin e ndryshimeve në kurrikulë duke e përfshirë praktikën profesionale si lëndë me 12 ECTS. <u>GVJ rekomandon që për këtë lëndë, krahas sylabusit, të përcaktohet një procedurë për marrëdhëniet me ambientin pritës (kontrata) dhe të përfshihet ajo në DVV.</u></p> <p>Referenca:</p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- Annex 31- Staf_Guide_2022_2023</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Plani mesimor i perditesuar për çdo profil të programit.pdf</p> <p>-Vendimi i Senatit qe eshte miratuar ndryshimi i planit mesimor.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që tek Universiteti Epoka personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies. GVJ, nisur edhe nga shqetësimet që kishte ekipi drejtues i fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, rekomandon që të plotësohet oragnika e personelit, duke shmugur luhatjen vjetore në numër (5 deri 7)si dhe të plotësojë dokumentacionin për realizimin e praktikës profesionale e përfshirë tashmë si lëndë e detyrueshme në planin mësimor të programit të studimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Duke shqyrtur dokumentacionin e DVV si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që universiteti Epoka siguron si ambiente për zhvillimin e aktivitetit mësimor e kërkimor shkencor, në vartësi të numrit të studentëve dhe grupeve mësimore: 7 auditore, 1 sallë konferencash, 9 klasa për seminare dhe 9 laboratorë. Në këto ambiente, duke marrë në konsideratë specifikat e PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”, aktivitet zhvillohen në plotësim të standardeve të kërkuara. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -Summary Tables_MSc CE_Annex 52.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ konstaton që ky kriter plotësohet në nivel bashkëkohor. Të gjitha auditorët, klasat dhe laboratorit ishin të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantonin realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Në takimin me studentët, GVJ u informua që metodat e mësimdhënjes për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile” ishin edhe të larmishme dhe eficiente. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ Summary Tables_MSc CE_Annex 52.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe	GVJ vizitoi laboratorin e inxhinierisë së ndërtimit, i cili përdoret për studimin e materialeve të ndryshme, veçanërisht të betonit, tërmeteve dhe elementeve të tyre. Ky laborator vlerësohet si një nga asetet më të rëndësishme të Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Në këtë laborator studentët kanë mundësinë të

<p>mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>përdorin teknologjinë paisjet laboratorike për kërkime të ndryshme shkencore individualisht ose në grup. Laboratori i Inxhinierisë së Ndërtimit ka një sipërfaqe totale prej 283 m². Studentët na informuan që laboratori përmban aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”. Ndër të tjera, në laboratorin e inxhinierisë së ndërtimit njehsoheshin nëpërmjet eksperimentimit sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rezistenca në shtypje e betonit; - Prova e shpimit të bërthamës së betonit; - Rezistenca në tërheqje e shufrave të çelikut; - Test i aktivitetit puzzolanik; - Graviteti specifik i kursit dhe testi i agregatit të imët; - Papastërtia organike e argjilës ose materialeve të tjera; - Testi i Kohës së Hidratimit të Çimentos; - Fortësia dhe qëndrueshmëria e çimentos; - Testi i rënies; - Zbulimi i përforcimit në strukturat RC; - Testi Schmidt Hammer; - Testi Los Angeles etj; <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52.
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas</p>	<p>Ky kriter plotësohet pasi universiteti Epoka vë në dispozicion të programeve të studimit 4 laboratore të teknologjisë së informacionit, të paisura me PC dhe programe profesionale edhe për natyrën e PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”. Disa nga këto programe integrohen edhe në paisjet e laboratorit të inxhinierisë së ndërtimit.</p>

<p>natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Nga materialet e DVV dhe gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që universiteti Epoka ofron më shumë se 20 ambiente për aktivitetet mësimore e kërkimoro-shkencore (auditorë, klasa seminaresh e ushtrimesh, salla konferencash, sallë biblioteke etj). Këto mjedise janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të dedikuara për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit "Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile" dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së këtij programi studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstaton që literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (anglisht) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Ky konstatim mbështetet edhe nga studentët, në takimin që GVJ organizoi me to.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none">-RVB-Shënime nga vizita në Institucion- https://www.epoka.edu.al/-Summary Tables_MSc CE_Annex 52- Annex 34- CE books.pdf- Annex 34.1 - Library Procedures.pdf
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Drejtuesi i bibliotekës së universitetit Epoka e informoi hollësisht GVJ mbi fondin e pasur të bibliotekës, bashkëpunimin e frytshëm me Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit, masën e përdorimit të literaturës nga studentët, konsiderimin e sugjerimeve e kërkesave të pedagogëve dhe studentëve si dhe dobinë e abonimit nga institucioni tek libraria digjitale JSTOR.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none">-RVB-Shënime nga vizita në Institucion- https://www.epoka.edu.al/-Summary Tables_MSc CE_Annex 52
	<ul style="list-style-type: none">- Annex 34- CE books.pdf- Annex 34.1 - Library Procedures.pdf

<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ky kriter plotësohet pasi universiteti Epoka ka një bibliotekë me sipërfaqe prej 400 metra katror. Qëllimi i saj është për të mbështetur aktivitetet arsimore, shkencore dhe kërkimore të stafit akademik dhe të studentëve. Gjatë vizitës në ambientët e bibliotekës, GVJ konstaton që ajo përbëhet nga tri njesi, një sallë leximi me një kapacitet prej 100 vendesh, pjesën e Bibliotekës me rreth 25000 libra, një qendër kërkimore me bibliotekë on-line dhe njesinë administrative të Bibliotekës. Biblioteka garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë të fondit, ofertës dhe ambienteve të saj edhe nga studentët e programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”. Nga biseda me studentët GVJ u informua që ata ishin të kënaqur me shërbimin e bibliotekës.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52 - Annex 34- CE books.pdf - Annex 34.1 - Library Procedures.pdf
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekën e universitetit Epoka, GVJ konstaton që ajo ishte e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës edhe të programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”. Kapaciteti i bibliotekës arrin deri në 100 vende ndërsa fondi fizik përbëhet prej rreth 25000 libra.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52 - Annex 34- CE books.pdf

	- <i>Annex 34.1 - Library Procedures.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	<p>Ky kriter plotësohet nëpërmjet abonimit që ka bërë institucioni në librarine dixhitale JSTOR. Burime të tjera në dispozicion të stafit dhe të studentëve janë edhe Cambridge Journals online, IOP Science si dhe depon dixhitale Dspace, nga ku mund të aksesohen të gjitha burimet akademike dixhitale kombëtare e ndërkombëtare.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52 - Annex 34- CE books.pdf - Annex 34.1 - Library Procedures.pdf
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që biblioteka është e paisur me programe kompjuterike dhe teknologji të tjera, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët që e frekuentojnë atë.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52 - Annex 34- CE books.pdf - Annex 34.1 - Library Procedures.pdf
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<p>Në universitetin Epoka biblioteka qëndron e hapur prej orës 08.30 deri në orën 16.30. Nga studentët e PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”, të cilët e zhvillojnë mësimin pasdite, biblioteka shfrytëzohej sipas nevojave në orarin e punës së saj, por edhe nëpërmjet komunikimit me personelin e bibliotekës, për të krijuar mundësi të posaçme frekuentimi. Gjatë takimit me studentët ata pohuan për GVJ se ishin të kënaqur me shërbimet e bibliotekës.</p> <p><i>Referenca:</i></p>

	<p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</p> <p>- Annex 34- CE books.pdf</p> <p>- Annex 34.1 - Library Procedures.pdf</p>			
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Në takimet me personelin akademik dhe studentët si dhe gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ u informua për cilësinë e fondit fizik dhe fondit online të saj. Ata pohuan që fondi përditësohej në mënyrë të vazhdueshme dhe se përdorimi i tij ishte efektiv në plotësimin e nevojave, kryesisht me literaturë profesionale (libra dhe revista). Sugjerimet dhe kërkesat e tyre përcilleshin edhe në department edhe direct tek personeli i bibliotekës dhe merreshin në kondisera të prej tyre me përparësi.</p> <p>Referenca:</p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</p> <p>- Annex 34- CE books.pdf</p> <p>- Annex 34.1 - Library Procedures.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Në shqyrtimin përmbljedhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që programi i studimit "Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile"përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset e posaçme etj).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti Epoka disponon sistemin e menaxhimit EIS (Europa Interactive System) nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomim. Çdo student ka llogarinë e tij të dedikuar në këtë system. Në takimin me studentët, GVJ u informua që ky system funksionon në mënyrë të pandërprerë dhe i plotëson të gjitha kërkesat për shërbimet që u nevojiten atyre.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none">-RVB-Shënime nga vizita në Institucion- https://www.epoka.edu.al/-Summary Tables_MSc CE_Annex 52-Annex 36 - EIS GuideLine -Annex 36.1 - EIS GuideLine - StudentsAnnex 37- ICTC Office Services.pdf
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi EIS administrojnë edhe informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”. Në takimin me personelin akademik, GVJ u informua që ky system funksionon në mënyrë të pandërprerë dhe i plotëson të gjitha kërkesat për shërbimet që u nevojiten atyre.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none">-RVB-Shënime nga vizita në Institucion- https://www.epoka.edu.al/-Summary Tables_MSc CE_Annex 52

	<p><i>-Annex 36 - EIS GuideLine -</i></p> <p><i>Annex 36.1 - EIS GuideLine - Students</i></p> <p><i>Annex 37- ICTC Office Services.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Duke qenë se sistemi EIS shërben si sistem i menaxhimit të brendshëm në universitetin Epoka, ai siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>-RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</i></p> <p><i>-Annex 36 - EIS GuideLine -</i></p> <p><i>Annex 36.1 - EIS GuideLine - Students</i></p> <p><i>Annex 37- ICTC Office Services.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit EIS është i instaluar në platformën Google, arrihet nëpërmjet adresës së dedikuar për çdo individ dhe përmban module insertimi, leximi dhe editimi, të cilat mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>-RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</i></p> <p><i>-Annex 36 - EIS GuideLine -</i></p> <p><i>Annex 36.1 - EIS GuideLine - Students</i></p> <p><i>Annex 37- ICTC Office Services.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e</p>	<p>Sistemi i menaxhimit EIS garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Informacionet jepen nëpërmjet domenit</p>

<p>administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>https://www.epoka.edu.al/, i cili i afishon ato në rubrika të posaçme.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</p> <p>-Annex 36 - EIS GuideLine -</p> <p>Annex 36.1 - EIS GuideLine - Students</p> <p>Annex 37- ICTC Office Services.pdf</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Universiteti Europa ka domenin e tij në internet, platforma google, i cili arrihet në adresën https://www.epoka.edu.al/. Në këtë adresë gjenden të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në rang institucioni, njësishtë kryesore, njësishtë përgjegjëse, programesh studimi etj. Të gjitha publikimet në këtë faqe janë në gjuhën anglisht dhe shqip.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</p> <p>-Annex 36 - EIS GuideLine -</p> <p>Annex 36.1 - EIS GuideLine - Students</p> <p>Annex 37- ICTC Office Services.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmblidhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit institucional ESI dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Referuar DVV dhe vizitës në Universitetin Epoka, GVJ konstaton që ky institucion harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshëm për mbarëvajtjen e njësive përbërse të tij, ku përfshihet edhe Departamenti i Inxhinjerisë si njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit “Msc në inxhinieri ndërtimi me profile”. Raporti financiar dhe plani mbështetës hartohen çdo vit duke marrë në konsideratë të gjitha shpenzimet e vitit të kaluar dhe të gjitha nevojat e kërkesave për vitin në vazhdim. Procedura që ndiqet është konform dispozitave ligjore që përcaktojnë raportimet mbi shpenzimet, të ardhurat dhe planifikimin e buxhetit. Buxheti miratohet nga Bordi i Administrimit. Duke marrë në konsideratë përvojën e krijuar nga ky institucion, buxhetin e pavarur të tij si dhe produktet e realizuara në vite, GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Burimet e financimit në universitetin Epoka janë: tarifat e studentëve (kryesisht), projektet kërkimore ndërkombëtare dhe fonde të tjera kërkimore kombëtare e ndërkombëtare. Të gjitha fondet e siguruara shërbejnë për financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, e shpenzimeve operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, e shpenzimeve për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, pagesën e detyrimeve financiare etj. Të gjitha këto shpenzime i shërbejnë realizimit të programeve të studimit.</p> <p>Duke marrë në konsideratë që peshën kryesore të financimit të këtij Programi Studimi e përbajnë tarifat e studentëve, zvogëlimi i numrit të tyre, do të kërkojë rritjen e tarifës deri në nivel ose të papërbalueshëm ose jo interesant në raport me konkurrencën, çfarë mund të rrezikojë mbylljen e tij.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Universiteti Epoka është pjesë e shoqërisë aksionere “Turgut Ozal Sh.a”. Kjo shoqëri kryen auditimin e jashtëm vjetor financiar në lidhje me situatën financiare dhe harton një raport të detajuar, i cili gjendet në zyrat qendrore të kompanisë. Ky raport përmban gjithë analizën e të dhënave për shpenzimet dhe të ardhurat e kompanisë. GVJ gjykon plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi</p>	<p>Gjatë vizitës në universitetin Epoka, GVJ u informua që ky institucion raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse, Departamentin e Inxhinierisë për programin e studimit “Msc në</p>

realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	inxhinieri ndërtimi me profile”, mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Referuar RVB, GVB u informua që dokumenta të tillë si “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Pasqyra e performancës”, buxheti vjetor institucional etj përmbajnë tregues financiar që dëshmojnë qëndrueshmërinë financiare të institucionit për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52			
Konkluzione	<i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka në stadin aktual garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. GVJ gjykon që në perspektivë, me zvogëlimin e numrit të studentëve, tarifat e studimit ose mund të bëhen të papërbalueshme ose jo interesante në raport me konkurrencën.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
----------------------------------------------------------	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

				X
--	--	--	--	---

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Referuar DVV, RVB, takimeve gjatë vizitave në institucion, portalit të dedikuar Universitetit Europa (https://www.epoka.edu.al/), GVJ konstaton që Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Dokumentet bazë si “Statuti i universitetit Epoka” “Rregullorja bazë”, “Rregullorja e Fakultetit” etj përmbajnë politikat dhe procedurat që ndiqen gjatë gjithë kohës së studimeve (kriteret e pranimit, plani mësimor, syllabuset, detyrimet dhe të drejtat etj). Të gjitha këto politika dhe procedura publikohen për tu vënë në dispozicion të të interesuarve. Për studentët, në veçanti, njohja me politikat dhe procedurat fillon me javën orientuese. Në këtë kohë ai “miqësohet” edhe me ambientet mësimore si dhe shërbimet që ofron veçmas institucioni. E gjithë ecuria e procesit të diplomimit për çdo student dokumentohet dhe ruhet në institucion, pa afat. Në takimin me studentët GVJ u informua se ata i njihnin këto politika dhe procedura dhe konfirmonin që zbatimi i tyre ishte në dobi të gjithë aktivitetit të tyre në institucion. Konkretisht me studentët u diskutua për politikat që ndiqen lidhur me dhënjen e bursave. Ata ishin të kënaqur me kriteret që ndiqeshin për dhënjen e tyre dhe pohonin që ato ishin edhe sociale edhe motivuese.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p>

	<p><i>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</i></p> <p><i>- Annex 1- Statute of Epoka University</i></p> <p><i>Annex 1.1- Basic Regulation.</i></p> <p><i>Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Jo vetëm në dokumentacionin e konsultuar por edhe në takimet në insitucion, kryesisht gjatë takimit me studentët, GVJ konstaton që politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi me profile”. Si të drejtat ashtu edhe detyrimet ishin të njohura nga studentët edhe nëpërmjet dokumentacionit të publikuar nga institucioni, edhe nga veprimtaria konkrete që zhvillohej gjatë kohës së studimeve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të konsulencës nga zyrat përkatëse.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>-RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</i></p> <p><i>- Annex 1- Statute of Epoka University</i></p> <p><i>-Annex 1.1- Basic Regulation.</i></p> <p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</i></p> <p><i>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Plotësimi i këtij kriteri konstatohet në gjithë dokumentacion e publikuar në faqen e dedikuar në internet për institucionin. Universiteti Epoka pranon në të gjitha programet e studimit studentë vendas dhe të huaj bazuar në kuotat e studentëve, të propozuara nga Bordi administrativ i Universitetit dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit. Përpos kriterëve të tjera si nota mesatare e specifikuar për studentët që vijnë nga programi bachelor i Universitetit Epoka dhe nga programi bachelor i universiteteve të tjera apo niveli i aftësisë në gjuhën angleze, si kriter të veçantë për të përthithur studentë sa më cilësorë, universiteti publikon edhe politikën e tij lidhur me dhënjen e</p>

	<p>bursave. Procesi i bashkëpunimit me maturën shtetërore bazohet në përcaktimet ligjore të Rregullores së Maturës Shtetërore (Nr, prot 12213/1, datë 23/11/2018) si dhe dispozitave të veçanta rregulluese.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52 - Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation. -Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf -Annex 30- Student_Guide_2022_2023.pdf
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ konsultoi gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion (DVV, RVB, Statutin e Universitetit, Rregulloren e fakultetit, publikimet në faqen e internetit) dhe konstaton që kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Faqja zyrtare në internet e universitetit Epoka në adresën https://www.epoka.edu.al/ ofron të gjitha informacionet e kërkuara. Po ashtu universiteti ka të organizuar në zyra të posaçme si Zyra e Pranimit të studentëve, Zyra e Koordinimit dhe Komisioni për Marrëdhëniet me Studentët, të gjitha shërbimet e kërkuara.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52 - Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation. -Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p><i>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023.pdf</i></p> <p>Duke iu referuar dokumentacionit të konsultuar, informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe publikimeve në faqen zyrtare https://www.epoka.edu.al/, GVJ konstaton plotësimin e këtij kriteri. Të gjitha kërkesat referohen në dispozitat ligjore dhe interesat e institucionit për të tërhequr kontigjente sa më cilësorë. Për kandidatët e pranuar shërben Zyra e pranimit, e cila u jep atyre informacione të detajuara për universitetin dhe njësitë e tij si dhe për programin e studimit përkatës.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52 - Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation. -Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf -Annex 30- Student_Guide_2022_2023.pdf
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Për të siguruar një përzgjedhje sa më të qëlluar të kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, GVJ u informua që universiteti Epoka është partner në projektin IDEA, që ka për objekt përmirësimin e aksesit, krijimin e kushteve të mësimit dhe zhvillimin e mundësive të punësimit për këtë kategori kandidatësh. Po ashtu Institucioni ka krijuar edhe një staf që vlerëson kapërcimin e pengesave që lidhen me këto kandidatë. Ky staf funksionon për çdo njësi.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52 - Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation.

	<p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</i></p> <p><i>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Për kandidatët që vijnë nga shtetet e tjera dhe kërkojnë të përfshihen në PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”, specifika e pranimit të tyre qëndron tek disponimi i diplomës Bachelor të ekuivalentuar, zotërimi në nivelin B2 të gjuhës angleze vlerësuar nga një listë provimesh të miratuar nga institucioni si dhe vlera e mesatares së ekuivalentuar në cilësinë e notës së vendosur për pranimet e kandidatëve vendas.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>-RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</i></p> <p><i>- Annex 1- Statute of Epoka University</i></p> <p><i>-Annex 1.1- Basic Regulation.</i></p> <p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</i></p> <p><i>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Për kandidatët që u përkasin shtresave në nevojë universiteti Epoka jep bursa sociale. Në këtë kategori përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fëmijë të policëve të vrarë në krye të detyrës • Jetimë që vijnë nga familje me të ardhura të ulta • Studentë që i përkasin komunitetit rom/egjiptian • Sportistë me rezultate të larta në kategoritë sportive përkatëse • Nxënës nga Bashkia Vorë. <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>-RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</i></p> <p><i>- Annex 1- Statute of Epoka University</i></p> <p><i>-Annex 1.1- Basic Regulation.</i></p>

	-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf -Annex 30- Student_Guide_2022_2023.pdf			
Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve si dhe diplomimin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Për plotësimin e këtij kriteri, GVJ konsultoi fillimisht “Rregulloren bazë të Universitetit Epoka” dhe “Guidën e studentit” dhe konstaton që ata japin një informacion të plotë e të qartë mbi kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Informacioni merr në konsideratë vlerësimin me nota në sistemin që përdor institucioni. Ky shërbim merret edhe nga interneti, ku gjendet i përfshirë në sistemin interaktiv të universitetit Epoka EIS. <i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52 - Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation. -Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf

	-Annex 30- Student_Guide_2022_2023.pdf
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Në dokumentacionin bazë të institucionit jepen informacionet që lidhen me kriteret dhe procedurat e njohjes të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Këto informacione merren edhe tek zyrat përkatëse të institucionit si Zyra e Koordinimit të Studentëve dhe Komisionit për Marrëdhëniet me Studentët apo tek sistemi i dedikuar EIS.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52 - Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation. -Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf -Annex 30- Student_Guide_2022_2023 Annex 17.2 - Directive On Student Transfer Annex 17.3- Student transfer.pdf
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Informacioni për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive jepen qysh në ditët e javës orientuese. Po ashtu në "Guidën e studentit" ata gjejnë informacionet e kërkuara për këtë rubrikë. Më tej informacionet merren edhe në faqen zyrtare të institucionit në internet në adresën https://www.epoka.edu.al duke kërkuar profilin përkatës të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Summary Tables_MSc CE_Annex 52 - Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation.

	<p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</i></p> <p><i>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit jepen në nenin 41 të “Rregullores për programet e studimit të ciklit të dytë” shtojca 3 dhe neni 56 i “Rregullores bazë të Universitetit Epoka”, shtojca 1.1. Në aspektin praktik studentët ndihmohen edhe nga Këshilltari i Fakultetit. Ja një informacion i nxjerrë nga adresa https://cen.epoka.edu.al/kreu-master-shkencor-702-704.html për tezën e masterit:</p> <p>Temat e tezës zhvillohen individualisht nga studenti në konsultim me këshilltarin e fakultetit. Për tu përgatitur për hulumtimet dhe shkrimin e tezës së tyre, studentët duhet të plotësojnë një kurs që ofron mësim në metodat e hulumtimit dhe shkrimit akademik. Komiteti i tezës përbëhet nga tre anëtarë, zakonisht anëtarë të Departamentit të inxhinierisë së ndërtimit në Universitetin Epoka. Studentët gjithashtu mund të ftojnë një lexues nga jashtë për të marrë pjesë në komitetin e tezës.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>-RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</i></p> <p><i>- Annex 1- Statute of Epoka University</i></p> <p><i>-Annex 1.1- Basic Regulation.</i></p> <p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</i></p> <p><i>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023</i></p> <p><i>-Annex 3- Regulation on Second Cycle.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve</p>	<p>Në universitetin Epoka ky kriter plotësohet duke organizuar javën e orientimit të studentëve, duke i paisur ata me guidën e studentit si dhe duke i rekomanduar studentët në rubrikat përkatëse të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>-RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p>

e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Summary Tables_MSc CE_Annex 52</p> <p>- Annex 1- Statute of Epoka University</p> <p>-Annex 1.1- Basic Regulation.</p> <p>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</p> <p>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023</p> <p>-Annex 3- Regulation on Second Cycle</p>			
Konkluzione	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti Epoka vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit "Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile". informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Referuar dispozitave ligjore, statutit të Universitetit Epoka, Rregullores bazë të UE", "Rregullores së fakultetit ti Arkitekturës dhe Inxhinierisë" etj, GVJ vlerëson që studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Gjatë takimit me studentët, GVJ konstaton që ata i kanë të gjitha informacionet e kërkuara.</p> <p>Referenca:</p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p>

	<p>- Annex 1- Statute of Epoka University</p> <p>-Annex 1.1- Basic Regulation.</p> <p>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</p> <p>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023</p> <p>-Annex 3- Regulation on Second Cycle</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët njihen me planin mësimor të profilit të tyre, syllabuset e çdo lënde, veprimtaritë përkatëse mësimore (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, detyra) dhe procedurat e vlersimit të njohurive. Këto informacione u transmetohen atyre në mënyrë të vazhdueshme qysh me fillimin e programit të studimeve e deri në diplomim. Sipas profilit të tyre, studentët udhëzohen ti gjejnë këto informacione edhe në faqen zyrtare të institucionit. Gjatë takimit me studentët GVJ konstaton që ata i zotërojnë të gjitha informacionet e kërkuara.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>- Annex 1- Statute of Epoka University</p> <p>-Annex 1.1- Basic Regulation.</p> <p>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</p> <p>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023</p> <p>-Annex 3- Regulation on Second Cycle</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Karrierës studentët informohen mbi mundësitë e punësimit si dhe mbështeten institucionalisht për orientimin drejt tregut të punës. Sipas statistikave të institucionit për punësimin rezulton që rreth 70% e studentëve të diplomuar janë punësuar në përputhje me diplomën dhe vetëm rreth 17% janë punësuar jo në përputhje me diplomën, ndërkohë që shkalla e përgjithshme e punësimit është rreth 90%. Këto tregues dëshmojnë kërkesën e lartë që ka tregu për studentët që përfundojnë studimet në PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”.</p> <p><i>Referenca:</i></p>

	<p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>- Annex 1- Statute of Epoka University</p> <p>-Annex 1.1- Basic Regulation.</p> <p>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</p> <p>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023</p> <p>-Annex 3- Regulation on Second Cycle</p> <p>Annex 52- Summary Tables.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Të gjithë studentët e PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”. kanë akses në sistemin interaktiv të universitetit Epoka EIS, ku gjejnë të gjitha informacionet për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, si dhe logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Po ashtu, në dispozicion të tyre janë edhe zyrat përkatëse në institucion të cilat i ofrojnë këto shërbime sa herë u kërkohen nga të interesuarit.</p> <p>Referenca:</p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Annex 36.1 - EIS GuideLine - Students</p> <p>-Annex 37- ICTC Office Services.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Ky kriter plotësohet me aksesin që kanë të gjithë studentët e PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”. në sistemin EIS.</p> <p>Referenca:</p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Annex 36.1 - EIS GuideLine - Students</p> <p>-Annex 37- ICTC Office Services.pdf</p>

Konkluzione	Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit "Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile". informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konsultoi tre regjistrat që duhet të disponohen në këtë sekretari sipas Udhezimit Nr.16,date 08.07.2019 për "PAJISJEN E INSTITUCIONEVE TE ARSIMIT TE LARTE ME REGJISTRIN THEMELTAR TE STUDENTEVE, REGJISTRIN E ARRITJEVE AKADEMIKE DHE REGJISTRIN E LESHIMIT TE DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE". Nga shqyrtimi i tyre, GVJ konstaton që Universiteti Epoka disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit "Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile".</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Annex 18 - Registrar's Office. Procedures on Students Records.pdf - Annex 52- Summary Tables.pdf -Annex 36.1 - EIS GuideLine - Students -Annex 37- ICTC Office Services.pdf

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Plotësimi i këtij kriteri dëshmohej nga shqyrtimi i rregjistrave që ndodhen në sekretarinë mësimore. GVJ konstaton që rregjistrat plotësohen rregullisht, me shënime të qarta, pa korregjime dhe konform udhëzimit Nr.16, date 08.07.2019.

Referuar të dhënave që morëm në sekretarinë mësimore numri i studentëve sipas profileve për programin e studimit është si më poshtë vijon:

Viti akademik	Programi/profili	Te regjistruar për herë të parë	Të c' regjistruar	Totali
19-20	Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit;	10	0	10
	Menaxhim i Ndërtimeve;	5	0	5
	Inxhinieri e Resurseve Ujore	0	0	0
	Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit	1	0	1
20-21	Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit;	6	0	6
	Menaxhim i Ndërtimeve;	1	0	1
	Inxhinieri e Resurseve Ujore	3	2	1
	Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit	2	0	2
21-22	Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit;	9	1	8
	Menaxhim i Ndërtimeve;	2	0	2
	Inxhinieri e Resurseve Ujore	1	0	1
	Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit	0	0	0
22-23	Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit;	18	0	18
	Menaxhim i Ndërtimeve;	2	0	2
	Inxhinieri e Resurseve Ujore	1	0	0

	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="550 277 710 376">Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit</td> <td data-bbox="710 277 938 376">0</td> <td data-bbox="938 277 1125 376">0</td> <td data-bbox="1125 277 1394 376">0</td> </tr> </table>	Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit	0	0	0
Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit	0	0	0		
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konsultoi sistemin e interaktiv të informacionit EIS si dhe sistemin brendshëm të menaxhimit LMS dhe konstaton që të dhënat për studentët menaxhohen të plota, të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Çdo student kishte adresë të dedikuar për këto sisteme.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Annex 18 - Registrar's Office. Procedures on Students Records.pdf</p>				
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretarite mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Plotësimi i këtij kriteri realizohet nëpërmjet funksionimit të grupit të auditimit të brendshëm, i cili kryen auditime periodike dhe krijohet me vendim të rektoratit. Auditimet kryhen për çdo njësi akademike dhe administrative. Gjatë këtij auditimi vlerësohet dhe dokumentohet gjendja dhe saktësia e informacionit dhe të dokumentacionit, që lidhet me studentët dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. Grupi përgadit raportin e auditimit të brendshëm, i cili i jepet rektoratit dhe njësive përkatëse për plotësimin e boshllëqeve dhe parregullsisve të konstatuara.</p> <p><i>Referenca:</i> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Annex 54.1 -Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports.pdf</p>				

<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në aneksin 26 të DVV është listuar Rraporti Vjetor i Departamentit të Inxhinierisë Ndërrimit për sejcilin nga profilet e PS “Msc në Inxhinieri Ndërrimi me profile” (Inxhinieri e Strukturave të Ndërrimit, Menaxhim i Ndërrimeve, Inxhinieri e Resurseve Ujore, Inxhinieri e Materialeve të Ndërrimit). GVJ e konsultoi këtë dokument që përmban cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Annex 54.1 -Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports.pdf - Annex 52- Summary Tables.pdf 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti Epoka mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve</p>	<p>Në shqyrtim të DVV, GVJ konsultoi të gjitha dokumentat që lidhen me përfshirjen dhe angazhimin e studentëve, përkatësisht përfaqësuesve të tyre, në organet vendimmarrëse e këshilluese mbështetur me akte ligjore dhe rregullatore të Universitetit Epoka. Në Statutin e institucionit thuhet që studentët janë pjesë e organeve vendimmarrëse të universitetit, duke përmbushur kështu një detyrim ligjor që rrjedh nga ligji për arsimin e lartë</p>

<p>ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>80/2015. Në zbatim të këtij përcaktimi, në Universitetin Epoka funksionon Këshilli Studentor, që përbëhet nga studentë të zgjedhur nga vetë studentët. Këshilli Studentor angazhohet për të përcjellë kërkesat e studentëve në Administratën e Universitetit. Objektivi bazë i KS është të sigurojë zhvillimin akademik të studentëve dhe rritjen e tyre në aspektin social e individual. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre (kryetarin dhe nënkryetarin e Këshillit Studentor) në senat. Nënkryetari i Këshillit Studentor për çështjet e sigurimit të cilësisë është antar i Komisionit Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë. Nënkryetari i Këshillit Studentor për etikën është antar i Bordit të Etikës. Dy antarë të Këshillit Studentor janë antarë të Komisionit të përhershëm të Marrdhënieve Studentore. Një student është në përbërje të grupit për hartimin e RVB. Referuar këtyre angazhimeve të studentëve GVJ konstatoon plotësimin e këtij kriteri.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation. -Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf -Annex 30- Student Guide 2022_2023 -Annex 20- Statute_of_Student_Council.
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në takimin me studentët, GVJ u interesua të informohej për mendimin që kishin ata lidhur me “forcën” e zërit të tyre në organet ku ata përfaqësoheshin dhe konstatoon që vlerësimi i tyre ishte i lartë. Pra, ata ndjeheshin të përfaqësuar plotësisht në vendimmarrjen, këshillimin apo vlerësimin mbi procesin akademik.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/

	<p>- Annex 1- Statute of Epoka University</p> <p>-Annex 1.1- Basic Regulation.</p> <p>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</p> <p>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023</p> <p>-Annex 20- Statute_of_Student_Council</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Në takimin me studentët, GVJ u interesua të informohej për rolin e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Në përgjigje të këtij interesimi, studentët konfirmuan angazhimin e tyre në rishikimin e planit mësimor. Në diskutimet me pedagogët e lëndëve, përkatësisht moduleve, ata kishin sugjeruar ndryshime në përmbajtjen e disa lëndëve si CE 548 “Dinamika...” dhe këto sugjerime ishin marrë në konsideratë. Po ashtu studentët kishin dhënë mendimet e tyre për përfshirjen e Praktikës Profesionale në Planin Mësimor, dhe keto mendime ishin konsideruar në vendimmarrje.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>- Annex 1- Statute of Epoka University</p> <p>-Annex 1.1- Basic Regulation.</p> <p>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</p> <p>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023</p> <p>-Annex 20- Statute_of_Student_Council</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/</p>	<p>Në takimin me studentët, GVJ u interesua të informohej sa konsiderohej dhënia e mendimit të tyre për barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, ankimimit të rezultatit si dhe rishikimit e reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Në përgjigje të këtij interesimi ata u përgjigjen për konsiderimin e plotë të të gjithë problematikave që ngrinin lidhur me vlersimin. Ata pohuan njohjen dhe ndjekjen e të gjitha procedurave që kanë të bëjnë me vlersimin.</p>

njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation. -Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf -Annex 30- Student_Guide_2022_2023 -Annex 20- Statute_of_Student_Council 			
Konkluzione	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Procedurat dhe njësitë e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në Universitetin Epoka janë ngritur e funksionojnë mbi bazën e Statutit të Universitetit, “Rregullores Bazë” të tij si dhe dispozitave të tjera ligjore në zbatim të përcaktimeve të ligjit 80/2015. Këshilli Studentor dhe Dekanati i Studentëve kanë për detyrë respektivisht të përfaqësojnë studentët dhe të përcjellin në organet kompetente të institucionit problemet që i shqetësojnë dhe të marrin përsipër zgjidhjen e tyre. Ata i informojnë studentët për përcjelljen dhe realizimin e kërkesave të tyre. Në takimin me Dekanin e Studentëve ai e informoi GVJ për mënyrën se si vilen kërkesat e studentëve me</p>

	<p>anë të formularëve. Ai referoi ekzistencën e 2 formularëve: formularit të çështjeve akademike dhe formularit të çështjeve administrative, ku studentët paraqesin mendimet, sugjerimet dhe kërkesat e tyre. Në dispozicion të informimit e shërbimit të studentëve janë edhe zyrat e posaçme si Zyra e Rregjistrimit, Zyra e Koordinimit të Studentëve, Zyra e Planifikimit të Karrierës.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation. -Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf -Annex 30- Student_Guide_2022_2023 -Annex 20- Statute_of_Student_Council
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sistemi i posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit në Universitetin Epoka lidhet më së pari me aksesin në Sistemin Interaktiv, EIS. Në këtë sistem çdo student ka adresë të dedikuar, e cila funksionon mbi bazën e adresës së E-Mail-it në domenin https://www.epoka.edu.al/ Në adresën e E-Mail-it dhe në rubrikat e sistemit EIS studenti informohet, merr këshilla, ndjek përparimin e tij dhe asistohet për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ - Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation. -Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf -Annex 30- Student_Guide_2022_2023

	<p><i>-Annex 20- Statute_of_Student_Council</i></p> <p><i>-Annex 18 - Registrar's Office. Procedures on Students Records.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë vizitës në Universitetin Epoka, GVJ u takua dhe me përfaqësues të Zyrës së Planifikimit të Karrierës për tu njohur konkretisht me aktivitetin e saj në dobi të informimit dhe orientimit të studentëve, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. GVJ konstaton se shërbimet e kësaj zyre janë efektive dhe me inters për studentët. Një aktivitet me mjaft peshë në këtë aspekt ishte edhe Panairi i Karrierës, ku nëpërmjet pjesmarrjes së biznesëve (në sezonin e vitit të kaluar kishin marrë pjesë 105 biznese) shkëmbeheshin interesimet e të dy palëve në lidhje me kërkesat dhe ofertat për punësim.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>-RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>- Annex 1- Statute of Epoka University</i></p> <p><i>-Annex 1.1- Basic Regulation.</i></p> <p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</i></p> <p><i>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023</i></p> <p><i>-Annex 20- Statute_of_Student_Council</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konsultoi statistikën e Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe mësoi që rreth 70% e studentëve të diplomuar janë punësuar në përputhje me diplomën dhe vetëm rreth 17% janë punësuar jo në përputhje me diplomën, ndërkohë që shkalla e përgjithshme e punësimit është rreth 90%. Këto tregues u vihen në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe dëshmojnë kërkesën e lartë që ka tregu për studentët që përfundojnë studimet në PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>-RVB</i></p>

	<p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>- Annex 1- Statute of Epoka University</p> <p>-Annex 1.1- Basic Regulation.</p> <p>-Annex 1.2- Regulation of Faculty.pdf</p> <p>-Annex 30- Student_Guide_2022_2023</p> <p>-Annex 20- Statute_of_Student_Council</p> <p>-Annex 52- Summary Tables.pdf</p>			
Konkluzione	<p><i>Në shqyrtimin përmblendhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe	Duke shqyrtuar DVV, RVB dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Universiteti Epoka disponon “Manualin e Sigurimit të Cilësisë në Universitetin Epoka” dhe “Politikat për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programeve të Studimit”. Në dokumentin e

<p>përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>strategjisë së institucionit për vitet 2018-2022 thuhet: “prioriteti strategjik i institucionit është ofrimi i një mjedisi me cilësi të lartë për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Fuqia e Universitetit Epoka qëndron në aftësinë e tij për të ofruar programe studimi që përdorin teknologjitë më të avancuara të mësimdhënies”.</p> <p>Realizimin e kësaj strategjie e gjen qysh tek mjediset ku zhvillohet aktiviteti mësimor e kërkimoro-shkencor, në kompozimin e planit mësimor, në hartimin e syllabuseve të çdo lënde, në rekrutimin e një personeli akademik dhe administrativ me nivel të lartë kualifikimi, në cilësinë e të gjitha shërbimeve, në thithjen e studentëve cilësorë dhe në shkallën e lartë të punësimit të tyre në tregun e punës. Në takimin me studentët, GVJ u informua për vlersimin e tyre ndaj metodave të mësimdhënies duke shprehur konsideratat më të larta.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Annex 16 - Quality Assurance Handbook -Annex 16.1 Quality Policy.pdf Annex 16.2 -Regulation On The_Organization and Functioning of the PCQA
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Njësia kryesore dhe njësia bazë e PS “Msc në Inxhinierinë e ndërtimit me profile” janë përkatësisht “Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë” dhe “Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit”. Këto struktura përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma monitorimi dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Për këtë qëllim shërbejnë kryesisht Anketat e Vlerësimit të Personelit dhe Vizitat në Auditore. Formularët plotësohen online dhe rezultatet i nxjerr sistemi në % për çdo përgjigje. Shefi i Departamentit i pasqyron këto të dhëna në raportin vjetor. Në bazë të rezultateve të këtyre formave merren masa për përmirësime duke ia referuar personelit problematikën e konstatuar. Po ashtu njësitë përgjegjësi organizojnë edhe trajnime kur kërkohen përdorime inovative si psh “trajtimi për edukimin dixhital”, organizuar nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Zyra e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>

	<p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation -Annex 1.2- Regulation of Faculty -Annex 16 - Quality Assurance Handbook -Annex 16.1 Quality Policy.pdf -Annex 16.2 -Regulation On The _Organization and Functioning of the PCQA
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Universiteti Epoka garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve, si dhe mundësinë e trajtimit të ankimimeve më së pari nëpërmjet “Anketës së Vlersimit të Instruktorëve të Kursit” e cila plotësohet nga çdo student në fund semestri dhe përbëhet nga 14 pyetje ku jepen përgjigje lidhur me zhvillimin e syllabuseve, komunikimin me auditorin, metodën e mësidhënies, vlersimin e performancës, përdorimin e kohës në leksione, seminare e laboratore etj. Rezultatet e anketimeve përfshihen në raportin vjetor që përgaditet nga Shefi i Departamentit. Në takimin me studentët, GVJ u informua që, nga ana e strukturave përgjegjëse merreshin të gjitha masat për zgjidhjen e ankesave dhe përmirësimin e dobësive të konstatuara.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Annex 16 - Quality Assurance Handbook -Annex 16.1 Quality Policy.pdf -Annex 16.2 -Regulation On The _Organization and Functioning of the PCQA -Annex 12.2- Course Instructor Evaluation Survey.pdf

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.

Publikimi i rezultateve të të gjitha gjetjeve të anketimit bëhet në faqen zyrtare të Universitetit Epoka si “Raport vjetor”. GVJ e konsultoi faqen zyrtare të institucionit dhe konstaton publikimin e të dhënave e rezultateve të anketimit si më poshtë:

Nr.	Pyetja	Vlerësimi mesatar për semestrin I	Vlerësimi mesatar për semestrin II
1.	Permbledhja dhe objektivat e lëndës ishin paraqitur qartë në syllabus	3.56	3.52
2.	Libri dhe/ose materialet e tjera të leximit të ndihmonin për të kuptuar temën	3.51	3.49
3.	Lënda rritu dijet dhe interesin tim mbi temën	3.48	3.44
4.	Metodat e mësimdhënies në këtë lëndë ishin të përshtatshme	3.49	3.46
5.	Pedagogu ishte përgatitur mirë për leksionet	3.58	3.53
6.	Pedagogu tregoi vëmendje për ecurinë time	3.36	3.38
7.	Pedagogu ishte i disponueshëm për të ndihmuar jashtë auditorit	3.46	3.47
8.	Pedagogu vinte në kohë në auditor	3.6	3.55
9.	Pedagogu vinte rregullisht në leksione	3.62	3.57
10.	Pedagogu përdori në mënyrë të përshtatshme materialet e lëndës në lidhje me temat	3.54	3.5
11.	Pedagogu e përdori gjuhën e mësimdhënies në mënyrë të efektshme	3.54	3.5
12.	Pedagogu e vlerësoi punën time në mënyrë të drejtë	3.5	3.46
13.	Pedagogu pati dialog efektiv me studentët gjatë leksioneve	3.5	3.47
14.	Pedagogu e përfshiu dhe motivoi klasën shumë mirë	3.45	3.42

Referenca:

-RVB

-Shënime nga vizita në Institucion

- <https://www.epoka.edu.al/>

-Annex 16 - Quality Assurance Handbook

-Annex 16.1 Quality Policy.pdf

-Annex 16.2 -Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA

-Annex 12.2- Course Instructor Evaluation Survey.pdf

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

Lidhur me plotësimin e këtij kriteri, GVJ konstaton që mbi bazën e rezultatit për çdo pedagog vlerësohet performanca e mësimdhënies në 5 nivele. Konkretisht niveli 1 (U) vlerësohet si “i pakënaqshëm” kur “nota” e studentëve është më e vogël se 2.5. Niveli 2 (I) vlerësohet si “është i nevojshëm përmirësimi” kur “nota” e studentëve është më e vogël se 3.0. Niveli 3 (ME) vlerësohet si “përmirësimi i nevojshëm” kur “nota” e studentëve është 3.0-3.5. Niveli 4 (EE) vlerësohet si “tejkalon pritshmëritë” kur “nota” e studentëve është 3.5-3.79. Niveli 5 (E) vlerësohet si “i jashtëzakonshëm” kur “nota” e studentëve është > 3.8. GVJ gjykon që kjo mënyrë vlerësimi nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

	<p><i>Referenca:</i></p> <p>-RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Annex 16 - Quality Assurance Handbook</p> <p>-Annex 16.1 Quality Policy.pdf</p> <p>-Annex 16.2 -Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA</p> <p>-Annex 12.2- Course Instructor Evaluation Survey</p>			
Konkluzione	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>GVJ konstaton që në Universitetin Epoka është ngritur e funksionon Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në përputhje me nenin 103 të Ligjit nr. 80/2015. Mbi këtë bazë janë hartuar aktet rregullatore të institucionit si Statuti, Rregullorja Bazë, Rregulloret e Njësiave Kryesore, Rregulloret e Programeve të Studimeve etj, të cilët kanë prodhuar strukturën e cilësisë që, në Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë përfshin Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave, Bordin e Provimeve dhe Bordin e Vlerësimit të Performancës Akademike. Kjo strukturë ka si produkt funksionimin, zhvillimin dhe realizimin e procesit mësimor e kërkimoro-shkencor me nivel të tillë cilësie, që konkretizohet</p>

	<p>tek të diplomuarit e tij të kërkuar dhe të pranuar nga tregu i punës vendas dhe i huaj deri në masën rreth 90%.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation -Annex 1.2- Regulation of Faculty -Annex 16 - Quality Assurance Handbook -Annex 16.1 Quality Policy.pdf -Annex 16.2 -Regulation On The _Organization and Functioning of the PCQA
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB, DVV (dokumentet “Plani Strategjik për Inxhinierinë e Ndërtimit”, “Misioni i PS “Msc Inxhinieri me profile” etj), si dhe të gjitha produktet e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë, GVJ gjykon që institucioni e ka të të ngritur dhe e mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. E gjithë struktura e tij zbaton strategjinë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke përfshirë edhe studentët edhe ekspertë të jashtëm si anëtarë të kësaj strukture.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation -Annex 1.2- Regulation of Faculty -Annex 16 - Quality Assurance Handbook -Annex 16.1 Quality Policy.pdf

	<p><i>-Annex 16.2 -Regulation On The _Organization and Functioning of the PCQA</i></p> <p><i>-Annex 12.2- Course Instructor Evaluation Survey</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Akreditimet nga ASCAL të Universitetit Epoka janë kryer sipas dispozitave ligjore për arsimin e lartë në vendin tonë. Gjetjet dhe rekomandimet e këtyre akreditimeve, mbështetur në treguesit e cilësisë të realizuar prej tij, kanë shërbyer në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë edhe për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”. GVJ shqyrtoi rastin konkret të rekomandimit të Bordit të Akreditimit për përfshirjen në planin mësimor, si lëndë e detyruar, të praktikës profesionale dhe gjeti konsiderimin e këtij rekomandimi në planin mësimor të përditësuar të këtij programi studimi.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>-RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Annex 1- Statute of Epoka University</i></p> <p><i>-Annex 1.1- Basic Regulation</i></p> <p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty</i></p> <p><i>-Annex 16 - Quality Assurance Handbook</i></p> <p><i>-Annex 16.1 Quality Policy.pdf</i></p> <p><i>-Annex 16.2 -Regulation On The _Organization and Functioning of the PCQA</i></p> <p><i>-Annex 12.2- Course Instructor Evaluation Survey</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime</p>	<p>Referuar DVV, RVB dhe vizitës në Universitetin Epoka GVJ konstaton përdorimin e treguesve të qartë për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore të institucionit. Këto tregues pasqyrohen në raportet periodike që harton institucioni dhe njësitë përbërse të tij. Ato janë të publikuar në adresën e faqes zyrtare të Universitetit Epoka https://www.epoka.edu.al/, kështu që mund të konsultohen prej cilitdo të interesuari, i cili pas konsultimit konstaton që ky institucion, mbështetur në treguesit cilësorë bën</p>

<p>nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>promovime nxitëse për arritjet më të mira edhe në programin e studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://www.epoka.edu.al/ -Annex 1- Statute of Epoka University -Annex 1.1- Basic Regulation -Annex 1.2- Regulation of Faculty -Annex 16 - Quality Assurance Handbook -Annex 16.1 Quality Policy.pdf -Annex 16.2 -Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA -Annex 12.2- Course Instructor Evaluation Survey -Annex 54.1 -Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports.pdf 			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara</p>	<p>GVJ konsultoi fillimisht DVV, që ka shërbyer si bazë e punës së Grupit të Vlersimit të Brendshëm për hartimin e RVB dhe konstatoi që kjo dosje përmban dokumentat e përcaktuara në aktet ligjore për evidentimin e nivelit të cilësisë në PS “Msc në</p>

<p>për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Inxhinieri Ndërtimi me profile”. Në vazhdim, gjatë vizitës në institucion, u kërkuar edhe disa dokumenta shtesë. Në shqyrtim dhe në analizë të gjithë këtyre materialeve, GVJ konstaton që dokumentat e prodhuara i shërbejnë akreditimit të PS.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Annex 1.1- Basic Regulation</i></p> <p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty</i></p> <p><i>-Annex 3- Regulation on Second Cycle</i></p> <p><i>-Annex 16 - Quality Assurance Handbook</i></p> <p><i>-Annex 16.1 Quality Policy.pdf</i></p> <p><i>-Annex 16.2 -Regulation On The _Organization and Functioning of the PCQA</i></p> <p><i>-Annex 54.1 -Internal Audit 2019 _Non-Compliance Reports</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ konstaton që në RVB, të prodhuar nga Grupi i Vlersimit të Brendshëm (GVB) si dhe në gjithë dokumentacionin e prodhuar nga zbatimi i akteve rregulluese ligjore përfshihen rezultate vlersimi, motivohen praktikat dhe arritjet më të mira, pasqyrohen masat e marra për përmirësimin në vijim të cilësisë si dhe motivohen arritjet më të mira në procesin mësimor dhe kërkimor shkencor nga i gjithë personeli akademik i angazhuar me PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Annex 1.1- Basic Regulation</i></p> <p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty</i></p> <p><i>-Annex 3- Regulation on Second Cycle</i></p> <p><i>-Annex 16 - Quality Assurance Handbook</i></p>

	<p>-Annex 16.1 Quality Policy.pdf</p> <p>-Annex 16.2 -Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA</p> <p>-Annex 54.1 -Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstaton që vizitat në auditore, si një metodë e drejtpërdrejtë, evidentojnë probleme që kanë të bëjnë me komunikimin e pedagogëve me auditorin, aktivizimin e studentëve, përdorimin e kohës në mësimdhënie etj.</p> <p>Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luan edhe auditimi i brendshëm që kryhet nga departamenti. Organizimi nga ana e institucionit i kurseve të kualifikimit, përbën një masë preventivuese për mënjanimin e dobësive që vinë nga paqartësi metodike e proceduriale.</p> <p>Referenca:</p> <p>RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Annex 16 - Quality Assurance Handbook</p> <p>-Annex 16.1 Quality Policy.pdf</p> <p>-Annex 16.2 -Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA</p> <p>-Annex 54.1 -Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në</p>	<p>GVJ konstaton që metoda të tilla të tërthorta vlersimi si “Anketa për Vlersimin e Instrukturëve të Kursit”, e cila plotësohet 2 herë në vit, në çdo fund semestri, me përmbajtjen e saj në 14 pika, rilevon edhe në gjerësi edhe në thellësi gjithë problematikën që lidhet me cilësinë e mësimdhënies, didaktikën, kurikulën etj. Kontaktet e vazhdueshme me Alumnin, edhe nëpërmjet anketës së posaçme që kryhet me antarët e tij nga Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Alumnit, si dhe organizimi i panairëve të karrierës. kontribuojnë po ashtu në përmirësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së PS. Në Universitetin Epoka organizohen edhe anketime të tjera si ai mbi kënaqësinë e kompanisë apo ai mbi kënaqësinë e stafit, nga të cilët merren të dhëna që përdoren në rritjen dhe përmirësimin e cilësisë. Universiteti Epoka, me shkallën e lartë të punësimit të të diplomuarve të tij, ka luksin të</p>

<p>realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>tërheqë nga sipërmarrjet ku janë të punësuar kontigjentet e tij, konsiderata e vlersime që i shërbejnë institucionit në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Annex 16 - Quality Assurance Handbook</i></p> <p><i>-Annex 16.1 Quality Policy.pdf</i></p> <p><i>-Annex 16.2 -Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA</i></p> <p><i>-Annex 54.1 -Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi GVJ vlerëson që Universiteti Epoka monitoron dhe vlerëson përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin</p>	<p>Referuar Ligjit 80/2015 si dhe akteve rregullatore ligjore të institucionit që burojnë nga zbatimi i këtij ligji, Statutit dhe Rregulloreve të tij, GVJ konstaton që në Universitetin Epoka, në politikat dhe procedurat lidhur me sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”, parashikohet dhe garantohet përfshirja e aktorëve të brendshëm e të jashtëm. Kështu në organet që merren me sigurimin e cilësisë, si aktorë të brendshëm janë edhe studentët. Kontrolli i</p>

<p>e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>cilësisë bëhet periodikisht edhe nga ASCAL nëpërmjet akreditimeve.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Annex 1.1- Basic Regulation</i></p> <p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty</i></p> <p><i>-Annex 3- Regulation on Second Cycle</i></p> <p><i>-Annex 16 - Quality Assurance Handbook</i></p> <p><i>-Annex 16.1 Quality Policy.pdf</i></p> <p><i>-Annex 16.2 -Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA</i></p> <p><i>-Annex 54.1 -Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në aktet ligjore dhe rregullatore të institucionit përcaktohen të drejta dhe detyrime për të gjithë aktorët që merren me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në zbatim të këtyre përcaktimeve ligjore kryhen auditime të vazhdueshme rezultatet e të cilave publikohen edhe në Raportin Vjetor të Insitucionit. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton që përgjegjësi dhe detyra konkrete në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile kanë: Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit, Stafi akademik i rekrutuar për mësimdhënien, Stafi administrativ i rekrutuar për shërbimet. Të gjithë këto përbërës, përfshirë edhe studentët, me angazhimin e tyre në vlersim të mësidhënies dhe arritjes së rezultateve në përvetësimin e dijeve që ofron Universiteti, realizojnë detyrimet e tyre në sigurimin e brendshëm të cilësisë. GVJ gjykon që ky kriter për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile” plotësohet tërësisht.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p>

	<p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Annex 1.1- Basic Regulation</p> <p>-Annex 1.2- Regulation of Faculty</p> <p>-Annex 3- Regulation on Second Cycle</p> <p>-Annex 16 - Quality Assurance Handbook</p> <p>-Annex 16.1 Quality Policy.pdf</p> <p>-Annex 16.2 -Regulation On The_Organization and Functioning of the PCQA</p> <p>-Annex 54.1 -Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>GVJ, duke shqyrtuar DVV dhe RVB si dhe gjatë takimeve në institucion, gjykon që njësitë përgjegjëse për PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi”:</p> <p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit si dhe drejtuesit e tyre janë të angazhuar për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Ata, nëpërmjet përcaktimit të qartë të detyrave e përgjegjësive, kontrollit të zbatimit të tyre, respektimit të afateve kohore në realizimin e përgjegjësive, në bashkëpunim edhe me studentët, kanë krijuar një trupë aktive, puna e së cilës është shpërblyer me rezultate të larta si gjatë viteve të studimit ashtu e, kryesisht, në tregun e punës.</p> <p>Referenca:</p> <p>RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Annex 1.1- Basic Regulation</p> <p>-Annex 1.2- Regulation of Faculty</p> <p>-Annex 3- Regulation on Second Cycle</p> <p>-Annex 16 - Quality Assurance Handbook</p> <p>-Annex 16.1 Quality Policy.pdf</p> <p>-Annex 16.2 -Regulation On The_Organization and Functioning of the PCQA</p> <p>-Annex 54.1 -Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports</p>

<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Si aktorë të brendshëm në proceset e vlersimit të PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile” konsiderohen Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, stafi akademik, stafi administrativ si dhe studentët. Duke shqyrtuar DVV, GVJ konstaton që të gjithë këta aktorë janë përfshirë në procesin e vlersimit dhe detyrat që ata kanë kryer, kanë qenë të barazvlefshme në cilësi duke shmangur diskriminimin dhe pabarazinë.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Annex 1.1- Basic Regulation</i></p> <p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty</i></p> <p><i>-Annex 3- Regulation on Second Cycle</i></p> <p><i>-Annex 16 - Quality Assurance Handbook</i></p> <p><i>-Annex 16.1 Quality Policy.pdf</i></p> <p><i>-Annex 16.2 -Regulation On The_Organization and Functioning of the PCQA</i></p> <p><i>-Annex 54.1 -Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Si aktorë të jashtëm në procesin e vlersimit konsiderohen përfaqësues nga sipërmarrjet ku janë punësuar të diplomuarit e këtij programi studimi, antarët e Aluminit, ekspertët e akreditimit si dhe publiku i interesuar dhe i informuar mbi këtë program. GVJ konstaton që të gjithë këta aktorë kanë dhënë kontributin e tyre me ekspertizë e mendime të çmuara në lidhje me cilësinë dhe përmirësimin e saj.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Annex 1.1- Basic Regulation</i></p> <p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty</i></p>

	<p>-Annex 3- Regulation on Second Cycle</p> <p>-Annex 16 - Quality Assurance Handbook</p> <p>-Annex 16.1 Quality Policy.pdf</p> <p>-Annex 16.2 -Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA</p> <p>-Annex 54.1 -Internal Audit 2019_Non-Compliance Reports</p>			
Konkluzione	<p>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kriterëve të këtij standardi, GVJ vlerëson që Universiteti Epoka përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile” me profile” janë dokumentuar në aktet ligjore e nënligjore të Universitetit Epoka. Në pikpamje të realizimit, ato përbëjnë sfida të mëdha, kryesisht me konkurrencën brenda e jashtë vendit lidhur me kontigjentet dhe tregun e punës. Instituti ka interes që këto elementë të aktivitetit të tij të jenë transparente e të njihen gjerësisht. Për këtë, përveç botimeve në fashikuj të veçantë përfshirë në dokumentat bazë të institucionit ato janë publikuar edhe në faqen zyrtare të institucionit https://www.epoka.edu.al/.</p> <p>Referenca: RVB</p>

	<p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>Annex 25- 2020- 2021 Annual Report of the PCQA.</p> <p>Annex 26- Department Annual Report 2021-2022</p> <p>Annex 27- Institutional Report 2021-2022.pd</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Universiteti Epoka i ka botuar rezultatet e e vlerësimeve “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile” në kapituj të veçantë të përfshirë në dokumentat bazë të institucionit apo raportet vjetore, si broshura më vehte si dhe në faqen zyrtare të institucionit https://www.epoka.edu.al/. Gjatë vizitës në institucion, kryesisht në takimin me Personelin Akademik, GVJ u insteresua për respektimin e lirisë dhe etikës akademike dhe konstatoi respektimin e tyre. Po ashtu është respektuar dhe legjislacioni për ruajtjen e të dhënave personale.</p> <p>Referenca:</p> <p>RVB</p> <p>-Shënime nga vizita në Institucion</p> <p>- https://www.epoka.edu.al/</p> <p>-Annex 1.1- Basic Regulation</p> <p>-Annex 1.2- Regulation of Faculty</p> <p>Annex 25- 2020- 2021 Annual Report of the PCQA.</p> <p>Annex 26- Department Annual Report 2021-2022</p> <p>Annex 27- Institutional Report 2021-2022.pd</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në raportet vjetore, por edhe në analizat lidhur me rezultatet e vlerësimit, janë hartuar plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. GVJ konstaton që raportet e vlerësimit të jashtëm shqyrtohen nga drejtuesit e njësive përgjegjëse, përkatësisht programeve të studimit, të cilët kanë kompetencën dhe përgjegjësinë, në zbatim të detyrimeve ligjore, të hartojnë plane veprimi duke caktuar objektiva dhe afate konkrete. Plane veprimi hartohen edhe duke adresuar gjetjet e anketimeve si anketimet për vlersimin e instruktorëve të kursit, vlersimin e kënaqësisë së stafit apo të kënaqësisë së kompanisë.</p>

	<p><i>Referenca:</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Annex 1.1- Basic Regulation</i></p> <p><i>-Annex 1.2- Regulation of Faculty</i></p> <p><i>-Annex 25- 2020- 2021 Annual Report of the PCQA.</i></p> <p><i>-Annex 26- Department Annual Report 2021-2022</i></p> <p><i>-Annex 27- Institutional Report 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>-Annex 54.1 -Internal Audit 2019_ Non-Compliance Reports.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Epoka, nëpërmjet strukturave të tij, që lidhen direkt me vlersimin e cilësisë si Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, (Organi përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë), shqyrton akte dhe procedura të cilat miratohen nga Senati Akademik. Pas miratimit, zbatimi i këtyre akteve dhe procedurave është i detyrueshëm. GVJ gjykon që procesi i zbatimit ka qenë efektiv dhe ka çuar në përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile”</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Annex 25- 2020- 2021 Annual Report of the PCQA.</i></p> <p><i>-Annex 26- Department Annual Report 2021-2022</i></p> <p><i>-Annex 27- Institutional Report 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Annex 25- 2020- 2021 Annual Report of the PCQA.</i></p> <p><i>-Annex 54.1 -Internal Audit 2019_ Non-Compliance Reports</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre</p>	<p>Në shqyrtim të DVV dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që Universiteti Epoka organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në takimin me personelin akademik, psh</p>

<p>për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>u pohua që rezultatet e anketimeve ndikonin direkt në ndërgjegjësimin e tyre lidhur me natyrën e gjetjeve dhe motivimin e tyre për tu ngjitur më lart në nivelet e vlersimit.</p> <p><i>Referenca:</i></p> <p><i>RVB</i></p> <p><i>-Shënime nga vizita në Institucion</i></p> <p><i>- https://www.epoka.edu.al/</i></p> <p><i>-Annex 11- Policy on Continuous Improvement of Study Program</i></p> <p><i>-Annex 12.1 Academic Performance Measurement and Assessment Form.</i></p> <p><i>-Annex 12.2- Course Instructor Evaluation Survey.</i></p> <p><i>-Annex 12.3 Course Instructor Evaluation Survey.pd</i></p> <p><i>-Annex 11- Policy on Continuous Improvement of Study Program</i></p> <p><i>-Annex 50- Student Satisfaction Survey</i></p> <p><i>-Annex 53- Academic Staff Satisfaction Survey Form</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në shqyrtimin përmbledhës të përmbushjes së kritereve të këtij standardi GVJ vlerëson që në Universitetin Epoka politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit "Msc në Inxhinierinë e Ndërtimit me profile" janë publike, transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
-----------------------------------------------------------------	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--------------------------------------------------------------------------

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në:
Inxhinieri Ndërtimi me profile: "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore"; "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit"**

a. Pika të forta:

1. Programi Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profilet "Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit"; "Menaxhim i Ndërtimeve"; "Inxhinieri e Resurseve Ujore" dhe "Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit", përputhet me misionin dhe objektivat e Institucionit;
2. Përkushtimi maksimal i stafit Akademik për përmbushjen e misionit dhe objektivave për këtë program studimi Msc në "Inxhinieri Ndërtimi". Metodatat e zbatuara në mësimdhënie nga stafi akademik, i cili është gjithmonë në kërkim të përmirësimit të vetvetes;
3. Staf lokal dhe ndërkombëtar të kualifikuar dhe me eksperiencë praktike profesionale, i cili transmeton dijet në mënyrën më të mirë dhe më të kuptueshme për studentët;
4. Mësimdhënia në gjuhën angleze, që përfshin përzgjedhjen e stafit mësimdhënës me kritere të njohjes së kësaj gjuhe, por edhe të studentëve;
5. Administrata e institucionit është profesionale, garanton shërbime të shpejta, cilësore, efektive dhe të sigurta. Vërehen cilësi në shërbime, siguri të informacionit, pacënueshmëri të të dhënave personale të individëve dhe një hierarki të urdhrave dhe funksioneve respektuese;
6. Menaxhimi i mirë i procesit të mësimdhënës dhe mësimnxënës. Një ndihmë për këtë është sistemi i menaxhimit dixhital që nga regjistrimi dhe deri në diplomim të studentëve;
7. Infrastruktura e vënë në dispozicion për realizimin e Programit Master i Shkencave në "Inxhinieri Ndërtimi", me profile, është në përputhje me standardet e vendit dhe të BE-së. Zhvillimi i procesit akademik dhe kërkimor në mjedise shumë miqësore dhe stimuluese si për studentet ashtu edhe për personelin akademik. Ekzistenca e laboratoreve të pajisura mirë dhe që mbështesin procesin mësimor. Biblioteka është një komponent shumë i rëndësishëm që i vjen në ndihmë studentit. Gjatë vizitës në IAL u konstatua që aty gjendej një numër i madh titujsh në gjuhën angleze që ju shërbejnë mjaft studentëve për tu thëlluar;
8. Menaxhimi i të ardhurave financiare, rritja e zërave buxhetorë si fondet për pagat e stafit në rritje, për kërkimin shkencor në kuptimin e gjerë, përfshirë këtu edhe aktivitetet, botimet, anëtarësimet në rrjete ndërkombëtare apo investime. Mbështetja që institucioni i jep personelit akademik për të zhvilluar kërkim shkencor;
9. GJV vlerëson se Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, me profile është përmbajtësor, i studiuar dhe i projektuar në mënyrë që të sigurojë një student profesionist të përgatitur në aspektin teorik dhe cilësi profesionale për tregun e punës në vend dhe Europë. Struktura, përmbajtja e kurrikulës dhe programet janë në përputhje me kriteret e përgjithshme

shtetërore për këto programe, me modele analoge të vendeve Europiane e atyre Anglosaksone dhe të kontekstualizuara në mjedisin dhe kërkesat globale e lokale të tregut të punës;

10. Projekte Ndërkombëtare të kërkimit shkencor në Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierisë, përkatesisht në Departamentin e Inxhinierisë së Ndërtimit janë të shumtë dhe tregojnë një dëshirë të institucionit për të bashkëpunuar dhe për të rritur kapacitetet njerëzore dhe fizike;
11. Punësimi “në përputhje me diplomën” në masën prej rreth 70% i të diplomuarve të këtij PS, është tregues shumë domethënës për vlerën e kurrikulës, përmbajtjen e syllabuseve, objektivitetin e vlersimeve dhe emrin e mirë që, për këto arsye, ka Universiteti Epoka;
12. Pozicioni i konsoliduar në tregun e punës përbën një motiv të fortë që PS “Msc në Inxhinieri Ndërtimi me profile” në Universitetin Epoka, të jetë i preferuar në raport me konkurrencën, për kontigjentet që duan të studiojnë në profilet që ofron ai;

b. Pika të dobta:

1. Mos aktivizimi për disa vite i disa prej profileve të studimit;
2. Paqëndrueshmëria numerike e stafit të këtij PS (nga 5 deri në 7) krijon probleme jo thjesht në shpërndarjen e ngarkesës por edhe në kompetencën profesionale për lëndën, përkatësisht modulën, lektori i së cilës duhet të zëvendësohet; *(Standardi IV.1, kriteri 3)*
3. Duke marrë në konsideratë që peshën kryesore të financimit të këtij PS e përbajnë tarifat e studentëve, zvogëlimi i numrit të tyre, do të kërkojë rritjen e tarifës deri në nivel ose të papërbalueshëm ose jo interesant në raport me konkurrencën, çfarë mund të rrezikojë mbylljen e tij; *(Standardi IV.5, kriteri 2)*

Rekomandime

1. GVJ rekomandon që shërbimet mbështetëse si Bibloteka, kantina dhe laboratorit të jenë të hapura dhe funksionale për studentët e masterit, duke parë oraret e tyre të studimit. Gjithashtu rekomandohet përdorim më i madh i laboratorit nga studentët e programit Master Shkencor;
2. GVJ rekomandon që në interes të PS, numri dhe ngarkesa e stafit akademik të stabilizohet për të mos patur shumë balancime në shpërndarjen e ngarkesës. GVJ, nisur edhe nga shqetësimet që kishte ekipi drejtues i fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë, rekomandon që të plotësohet oragnika e personelit, duke shmangur luhatjen vjetore në numër (5 deri 7);
3. GVJ rekomandon të zgjidhet problemi i qëndrueshmërisë numerike të personelit nëpërmjet ofertave motivuese dhe shpërblyese;
4. GVJ, duke marrë në konsideratë përfshirjen e praktikës profesionale si lëndë e detyruar në PS “Master shkencor në inxhinieri ndërtimi me profile” rekomandon hartimin e një procedure

(rregulloreje) të veçantë për organizimin, kryerjen dhe kontrollin e praktikës profesionale. GVJ rekomandon që për këtë lëndë, krahas sylabusit, të përcaktohet një procedurë për marrëdhëniet me ambientin pritës (kontrata);

5. GVJ rekomandon të rritet pesha e financimeve nga burime të tjera për të lehtësuar ngarkesën financiare në tarifën e studimeve;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program, master of Science: Civil Engineering with profiles: a. Structural Engineering; b. Construction Management; c. Construction Materials Engineering; d. Water Resources Engineering

a. Strengths and Affirmations:

1. Master of Science Program in "Civil Engineering", with profiles "Construction Structures Engineering"; "Construction Management"; "Water Resources Engineering" and "Building Materials Engineering", is consistent with the mission and objectives of the Institution;
2. The maximum dedication of the Academic staff to the fulfillment of the mission and objectives for this Msc study program in "Civil Engineering". The methods applied in teaching by the academic staff, who are always looking for self-improvement;
3. Qualified local and international staff with practical professional experience, who transmits knowledge in the best and most understandable way for students;
4. Teaching in English, which includes the selection of teaching staff with criteria of knowledge of this language, but also of students;
5. The administration of the institution is professional, guarantees fast, quality, efficient and safe services. Quality in services, information security, inviolability of individuals' personal data and a hierarchy of respectful orders and functions are noted;
6. Good management of the teaching and learning process. A help for this is the digital management system from registration to graduation of students;
7. The infrastructure made available for the realization of the Master of Science Program in "Civil Engineering", with profiles, is in accordance with the standards of the country and the EU. The development of the academic and research process in very friendly and stimulating environments for both students and academic staff. The existence of well-equipped laboratories that support the learning process. The library is a very important component that helps the student. During the visit to the HEI, it was found that there was a large number of titles in the English language that are useful enough for students to deepen;
8. Management of financial income, increase of budget items such as funds for increasing staff salaries, for scientific research in the broadest sense, including activities, publications, memberships in

international networks or investments. The support that the institution gives to academic staff to develop scientific research;

9. GVJ assesses that the Master of Science in Civil Engineering study program, with profiles, is comprehensive, studied and designed in order to provide a theoretically prepared student / professional with professional quality for the labor market in the country and Europe. The structure, content of the curriculum and programs are in accordance with the general state criteria for these programs, with analogous models of European and Anglo-Saxon countries and contextualized in the global and local labor market environment and requirements;
10. International scientific research projects in the Faculty of Architecture and Engineering, respectively in the Department of Civil Engineering are numerous and show a desire of the institution to cooperate and increase human and physical capacities;
11. The employment "in accordance with the diploma" in the amount of about 70% of the graduates of this PS, is a very significant indicator for the value of the curriculum, the content of the syllabuses, the objectivity of the evaluations and the good name that, for these reasons, Epoka University has;
12. The consolidated position in the labor market constitutes a strong motive for the PS "Msc in Civil Engineering with profiles" at Epoka University to be preferred in relation to the competition, for contingents who want to study in the profiles it offers;

Weak points

1. Non-activation for several years of some of the study profiles;
2. The numerical instability of the staff of this SP (from 5 to 7) creates problems not only in the distribution of the load but also in the professional competence for the subject, namely the module, whose lecturer must be replaced; (*Standard IV.1, criteria 3*)
3. Taking into consideration that the main weight of the financing of this SP is comprised of student fees, reducing their number will require the fee to be increased to a level that is either unaffordable or uninteresting in relation to the competition, which could endanger the closure of his; (*Standard IV.5, criterion 2*)

Recommendations

1. GVJ recommends that support services such as the Library, canteen and laboratory are open and functional for master's students, considering their study schedules. Also, greater use of the laboratory by students of the Master's program is recommended;
2. GVJ recommends that in the interest of SP, the number and workload of the academic staff should be stabilized in order not to have too many balances in the distribution of the workload. GVJ, based

on the concerns of the management team of the Faculty of Architecture and Engineering, recommends to complete the staff structure, avoiding the annual fluctuation in the number (5 to 7);

3. GVJ recommends to solve the problem of numerical stability of the personnel through motivational and rewarding offers;
4. GVJ, taking into consideration the inclusion of professional practice as a compulsory subject in PS "Scientific Master in construction engineering with profiles" recommends the drafting of a special procedure (regulation) for the organization, performance and control of professional practice. GVJ recommends that for this subject, in addition to the syllabus, a procedure for relations with the host environment (contract) is defined;
5. GVJ recommends increasing the weight of funding from other sources to ease the financial burden on the study fee;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI i PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI i PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI i CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X